

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP

- 10 VJET -
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE

(monografi)



Shkup, 2017

Botues:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve –
Shkup©ITSHKSH, 2017

“10 vjet - ITSHKSH”

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Redaksia e botimit:
Prof. dr. Sefer Tahiri
Prof. dr. Sevdail Demiri
Doc. dr. Besnik Emini

Sekretar i redaksisë:
Mr. Murtezan Idrizi

ISBN: 978-608-4653-66-0
www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë



**10 vjet - INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE**

PËRMBAJTJA:

NË VEND TË PARATHËNIES	5
THEMELIMI I INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP	9
Vitet 2007-2011	9
ECURIA NDËR VITE E VEPRIMTARISË SË ITSHKSH-SHKUP	19
Viti 2012	19
Viti 2013	24
Viti 2014	33
Viti 2015	41
Viti 2016	52
Viti 2017	66
SYNIMET E ITSHKSH-SË NË VITIN 2018	82
DREJTORËT E ITSHKSH-së.....	83
TË PUNËSUARIT AKTUAL TË ITSHKSH-së (2017)	85
Kiadri shkencor:	85
Kiadri administrativ:.....	88
VLERËSIME DHE URIME PËR PUNËN E ITSHKSH-së	89

NË VEND TË PARATHËNIES

Me rastin e përvjetorit të 10-të të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, e pamë të udhës që nëpërmjet kësaj monografie, ta paraqesim rrugëtimin tonë dhjetëvjeçar. Në ecurinë e profilizimit të vetë, Instituti është sfiduar nga rrethanat shoqërore e politike të kohës, dhe nga faktorët të tjerë. Por, në shënimin e përvjetorit të dhjetë, ai vazhdon të jep frytet e tij, duke e arsyetuar misionin themeltar.

Nevojat dhe kërkesat e kahershme vizionare të intelektualëve shqiptarë të vetëdijshëm për të pasur një institut shkencor në Shkup, u rrumbullakuan pikërisht me themelimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Kjo iniciativë veçmë ishte pjekur për t'u realizuar, për shkak se ndër vite, shumë intelektualë të shquar, nëpërmjet shkrimeve të tyre, e arsyetonin themelimin e një institucioni të mirëfilltë shkencor, i cili do të përkujdeset për gjuhën, letërsinë, historinë, kulturën, folklorin, etnologjinë, dhe nëpërmjet punës kërkimore-shkencore, të institucionalizojë e konservojë trashëgiminë e pasur shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve në këto treva.

Për realizimin sa më me sukses të detyrave të parashtruara, studiuesve të institutit iu desh të bëjnë përpjekje e të angazhojnë gjithë potencialin e tyre shkencor e krijues që disponojnë jo vetëm nga shkencat albanologjike, por edhe në fushat e tjera të përafërta me të. Rrjedhimisht, ky qëllim u arrit falë bashkëpunimit e bashkëveprimit me institutet e tjera këtu në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri, por edhe me institucionet e ngjashme shkencore evropiane dhe amerikane. Për këtë angazhim serioz në veprimtarinë tonë, shpeshherë instituti merret si model se si duhet funksionuar një institucion shkencor, i cili reflekton jo vetëm në qarqet shkencore, duke qenë pionier në paraqitjen e diversiteteve si pasuri kombëtare e shtetërore dhe kjo punë për një dekadë ka reflektuar në përafrimin etnik dhe fetar.

Instituti që në hapje kishte përkrahjen e rezervë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, dhe kjo shihet edhe nga vetë prezenca e ambasadores Xhilian Milovanoviç në ceremoninë e hapjes më 22 Nëntor 2007. Ky institut nga miqtë amerikanë shihej si një institucion i

cili nëpërmjet veprimtarisë së vetë shkencore, do të ketë për mision ngritjen e vetëdijes shoqërore për trashëgiminë kulturore, dhe do të jetë një urë lidhëse me bashkësitë e tjera etnike dhe fetare. Këtë përkrahje të fuqishme vazhduam ta kemi në kontinuitet edhe nga ambasadorët tjerë amerikanë në Shkup, si Filip Riker, Pol Uolers dhe së fundi Xhes Bejli. Gjatë këtyre dhjet viteve, ambasadorët amerikanë kanë përcjellë punën e Institutit, duke qenë shpesh në hapjen e konferencave dhe organizimet tjera. Me këtë rast për bashkëpunimin e mirëfilltë poashtu falenderojmë edhe këshilltarin politik të Ambasadës së SHBA-së në Shkup, Adrian Ismaili.

Gjatë këtyre dhjetë viteve, Instituti ka organizuar me dhjetëra konferenca të karakterit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar edhe në Uashington, Nju Jork dhe në qendrat e rëndësishme evropiane.

Për një dekadë punë, Instituti ynë po e arrin numrin treshifror në botimin e veprave shkencore.

Me sukses po botohet revista shkencore “Studime albanologjike”, ku shumë autorë i botojnë punimet e tyre hulumtuese, duke iu përmbajtur kritikës shkencore. Botimi i kësaj reviste shkencore shënon një arritje të rëndësishme dhe njëherësh një kontribut me vlerë të çmueshme në shkencat e albanologjisë. Përmes shkrimeve analitike hidhet dritë mbi ngjarjet historike, gjuhësore, etnologjike, dhe në përgjithësi të trashëgimisë tonë të pasur kulturore. Këto punime shërbejnë edhe për informimin e opinionit të gjerë publik e shkencor për çështjen shqiptare përgjithësisht, e sidomos për atë në Maqedoni. Përveç që revista botohet në formë të shtypur, të gjithë të interesuarit e kanë në shërbim në çdo kohë edhe nëpërmjet ueb-faqes sonë elektronike.

Në kuadër të veprimtarisë botuese-shkencore, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptare në Shkup, përveç revistës “Studime albanologjike”, e boton edhe një edicion tjetër periodik, i cili përfshin tekstet shkencore që dalin nga aktivitetet tona shkencore e cila e bartë emrin e vjetër të Shkupit (“Scupi”). Edhe kjo revistë gjendet në ueb-faqen e Institutit dhe mund të lexohet nga të gjithë të interesuarit, pa asnjë kompensim material.

Në këtë dhjetëvjetor, shkurtazi po i potencojmë edhe shqetësimet që i ka pasur ky Institut shqiptar herë pas here gjatë rrugëtimit të tij. Një theks i veçantë duhet vënë në fërkimet e subjekteve politike shqiptare, se ky projekt madhor për popullin shqiptar në Maqedoni, është themeluar nga një

subjekt tjetër politik, prandaj edhe shpeshherë ka munguar një përkrahje e merituar nga përfaqësuesit shqiptarë nëpër institucionet tona shtetërore.

Por, viteve të fundit, falë punës së palodhshme të punonjësve, Instituti me projektet e hartuara afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, po mëton që të jetë një institucion i respektuar shkencor i shqiptarëve të Maqedonisë. Besojmë se dalëngadalë po vetëdijesohen edhe strukturat shoqërore e politike për të përkrahur pa rezerva projektet e Institutit. Me këto projekte, do të zbardhen ngjarjet historike, do të vilet folklori i pasur në trevat tona autoktone, do të përpilohen fjalorë dhe monografi për t'u shkruar historia e popullit shqiptar në Maqedoni.

*Prof. dr. Skender Asani,
Drejtore i ITSHKSH-Shkup*

THEMELIMI I INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vitet 2007-2011

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup është themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 19-6306/1 të datës 27.03.2007, me statusin e Institucionit Publik Shkencor. Hartues i elaboratit për themelimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ishte Xhabir Ahmeti, ndërsa promotori dhe shtytësi kryesor i idesë për themelimin e Institutit shqiptar në Shkup, Arbër Xhaferi.

Në bazë të vendimit të themelimit, Instituti veprimtarinë hulumtuese-shkencore e realizon në fushat vijuese: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, histori e shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike të Shqiptarëve, etnologji, histori arti dhe arkitekturë popullore, lidhje të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes Shqiptarëve dhe Maqedonasve me popujt e tjerë në regjion. Duke u mbështetur në fushat e veprimtarisë hulumtuese-shkencore janë formuar edhe sektorët e Institutit edhe atë:

- Sektori i gjuhës shqipe;
- Sektori i letërsisë shqipe;
- Sektori i historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe i lëvizjeve demografike;
- Sektori i etnologjisë, historisë së artit dhe arkitekturës popullore; dhe
- Sektori i lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe popujve të tjerë në rajon.

Rreth përgatitjeve për punë të Institutit është ngarkuar komisioni i formuar për këtë çështje i përbërë prej:

1. Dr. Vebi Bexheti, profesor në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë;
2. Dr. Fadil Sulejmani, profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës;

3. Dr. Fejzulla Shabani, profesor në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë;

4. Dr. Zeqir Kadriu, profesor në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

5. Dr. Luljeta Isaku, profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Komisioni amë i formuar për përgatitjet për punë të Institutit zgjodhi kryetar dr. Zeqir Kadriun.

Komisioni duhej t'i kryejë detyrat vijuese:

- të miratojë statutin e përkohshëm të Institutit;
- të miratojë program për punën e Institutit;
- të kryej zgjedhje në thirrje shkencore dhe të bashkëpunëtorit;
- të vendosë për themelimin e marrëdhënieve të punës të kuadrit administrativ;
- të konstituojë Këshillin e Institutit si organ drejtues dhe
- detyra të tjera të nevojshme për fillim me punë të Institutit.

Në pozitën e ushtruesit të detyrës drejtor i Institutit u zgjodh dr. Mirushe Hoxha.



Pamje nga prerja e shiritit: Arben Xhaferi, Nikolla Gruevski, Sulejman Rushiti

Përirimi i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve u bë më 22 nëntor 2007 në oborrin e Hanit Kurshumli në Shkup. Në këtë solemnitet shiritin e kuq të fillimit me punë e prenë kryeministri i

Qeverisë së Republikës së Maqedonisë z. Nikolla Gruevski, kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare dhe deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë z. Arben Xhaferi dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës z. Sulejman Rushiti.




Fjalimi i u.d. drejtor i ITSHKSH-së, dr.Mirushe Hoxha



Pamje nga promovimi i ITSHKSH-së në objektet e Kurshumli Hanit në Shkup

Në fjalën e tij kreu i PDSH-së, Arbër Xhaferi u shpreh se hapja e ITSHKSH-së është ngjarje kulturore, politike por edhe historike. "Pa institucione vlerat e një populli përthahen, zvetënohen dhe humbin relevancën dhe nuk arrijnë që të funksionojnë si taban i fuqishëm për ndërtimin e identitetit, që shënon vazhdimësi me të kaluarën. Një popull pa institucione siç është ITSHKSH-ja e humb efikasitetin dhe motivin për ruajtjen e së kaluarës, gjë që shpie detyrimisht drejt asimilimit" tha Xhaferi. Ai në vizionin e tij për ITSHKSH-në tha se ky Institut duke mbledhur, skeduar dhe ruajtur trashëgiminë kulturore të njeriut, njëherësh do ta ruajë edhe dëshminë, vulën e së kaluarës.

Fjalë rasti mbajtën edhe Kryeministri i atëhershëm, Nikolla Gruevski, drejtoresha e ITSHKSH-së, dr. Mirushe Hoxha dhe ministri i atëhershëm i Arsimit dhe Shkencës, Sulejman Rushiti.



Faksimile e vendimit qeveritar për themelimin e ITSHKSH-së në Shkup



Objekti i ITSHKSH-së në Kurshumli Han në Shkup


Hapësirat e punës së Institutit u përcaktuan të jenë ambientet e katit të sipërm të Hanit Kurshumli në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, pranë godinës së Muzeut të Maqedonisë.

Në fillim të vitit 2008 në kuadër të sektorëve të ndryshëm për veprimtari hulumtuese e shkencore të Institutit u punësuan këto punonjës: dr. Qemal Murati, dr. Ferat Polisi, dr. Iljaz Huseini, mr. Alma Bejtullahu, mr. Hidajete Azizi, mr. Muharem Jahja, Agron Salihi, Besnik Emini, Ganimete Ramadani, Rini Useini. Në kuadër të sektorit për punë administrative e teknike u punësuan këto punonjës: Blerim Qaili-sekretar, Haxhere Osmani-kontabiliste, Nexhati Dema-shofer.

Më pas në sektorët shkencorë të Institutit u punësuan edhe: dr. Naim Halimi, dr. Skender Asani, dr. Bukuriye Mustafa, mr. Ardian Limani, Gëzim Sula, dr. Shefqet Zekolli, dr. Zeqirija Ibrahim, dr. Sefer Tahiri, dr. Sevdail Demiri, dr. Sejdulla Alili, mr. Murtezan Idrizi, dr. Ermal Mehmeti. Ndërsa, në kuadër të sektorit për punë administrative e teknike u punësuan: Arife Kovaçi, Elham Bislimi, Nebehate Bajrami dhe Hizer Asani.

Më 17.01.2008 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, në Teatrin Shqiptar në Shkup organizoi akademi shkencore e

solemne me rastin e shënimit të vitit jubilar të vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit - Skenderbeut.



Programi i manifestimit të parë të organizuar nga ITSHKSH-ja


Më 10.06.2008 në ambientet e Institutit në Hanin Kurshimli u mbajt akademi solemne për shënimin e 130-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Prizrenit.



Pamje nga Akademia solemne për shënimin e 130 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit

Në vitin 2009 doli botimi i parë periodik i Institutit, përkatësisht revista shkencore “Studime Albanologjike”, e cila del dy herë në vit, e që në vitin 2017 ka arritur në numrin 15. Në këtë revistë përfshihen arritjet më të fundit shkencore në sferën e shkencave albanologjike, ndërsa përpos hulumtuesve të Institutit, në të botojnë punime shkencore edhe mjaft emra të njohur të shkencës nga të gjitha trevat shqiptare.

Në gusht të vitit 2010 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Marrëvshjen e nënshkruan prof. dr. Ramiz Abdyli në emër të ITSHKSH-së, dhe prof. dr. Agron Reka në emër të USHT-së.



Prof. dr. Agron Reka dhe prof. dr. Ramizi Abdyli, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim me USHT-së dhe ITSHKSH-së

Në kuadër të Institutit funksionon edhe biblioteka, e cila është një segment i veçantë, por shumë i rëndësishëm i mbarëvajtjes së punës së ITSHKSH-së. Biblioteka numëron rreth 4 mijë tituj, kryesisht nga fusha e historisë, gjuhësisë, studimi i letërsisë, shkencat shoqërore dhe shuma fusha tjera. Biblioteka u themelua me vendim të Këshillit të ITSHKSH-së, i miratuar më 13 maj të vitit 2011, me nismën e punonjësit shkencor, Besnik Emini. Sipas këtij vendimi, Biblioteka themelohet për nevojat e të gjithë sektorëve të ITSHKSH-së, ndërsa për nevojat e saj shfrytëzohen fondet e blera dhe fondet e mara si donacion nga ITSHKSH-ja. Në procesin e regjistrimit në fillim kanë qenë të angazhuar mr. Besnik Emini, mr. Ardian Limani dhe mr. Murtezan Idrizi. Ndërsa, pas konsolidimit dhe sigurimit të kushteve të nevojshme hapësinore për funksionimin e Bibliotekës, në bibliotekë punon Ganimete Ramadani.

Më 21 nëntor 2011 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve organizoi Sesionin Shkencor «Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni». Në konferencë me kumtesat e tyre u paraqitën këta studiues: Akad. Kolec Topalli, Hysen Mato-shi, Avzi Mustafa, Agron Xhagolli, Leontina Gega-Musa, Luan Përzhita, Zeqirja Neziri, Agim Leka, Qemal Murati, Asllan Hamiti, Iza-im Murtezani, Mixhait Pollozhani, Halim Purellku, Fatmir Sulejmani, Sefer Tahiri, Zeqirija Ibrahim, Besnik Emini.



Punimet e sesionit "Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni"

Punimet e kësaj konference u botuan në numrin e parë të edicionit të botimeve të veçanta “Scupi”.

Më 13 dhjetor 2011 punonjësit e Institutit organizuar vizitë të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Dibër, ku u njoftuan më gjerësisht me gjendjen faktike të objekteve të objekteve të ndryshme të trashëgimisë kulturore në Dibër.



Pamje nga vizita e punonjësve të Institutit në Dibër më 2011

ECURIA NDËR VITE E VEPRIMTARISË SË ITSHKSH-SHKUP

Viti 2012

“Botën e zbulova përmes librave”, do thoshte Sartri, ndërsa Viktor Hygo me mendjemprehtësi do të konstatonte se “Libri në përgjithësi është rrugë nga e keqja kah e mira, nga padrejtësia kah e drejta, nga e pavërteta kah e vërteta, nga nata kah dita”.

Shumë mendime filozofike dhe shkencore, të shkruara në vepra të ndryshme kanë qenë pikëorientim dhe udhërrëfyes i civilizimit dhe progresit planetar.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, i vetëdijshëm për misionin fisnik shkencor dhe kombëtar që ka, pas konsolidimit të tij si institucion i mirëfilltë shkencor, prioritet kryesor pati dhe vazhdon të ketë botimin e veprave shkencore, si dhe revistave “Studime Albanologjike” e “Scupi”.

Vepra e parë shkencore, që u botua nga Instituti ynë është ajo me titull “Gjuha e romanit Lumi i vdekur”, i Jakov Xoxës, nga bashkëpunëtorja shkencore e Institutit, dr. Bukuriye Mustafa, vepër kjo që është një studim monografik për gjuhën e njërit nga shkrimtarët më të veçantë në letërsinë shqiptare, i cili ka ditur të shkruajë jo vetëm artistikisht, por edhe të krijojë gjuhë.

Prof.dr. Qemal Murati, këshilltar shkencor i Institutit thekson se “Me këtë vepër për gjuhën e një shkrimtari kaq kompleks, që nuk ka qenë e lehtë për t’u realizuar në përmasat e tilla të një monografie, autorja Dr. Bukuriye Mustafa,



dëshmon këmbënguljen e studiueses së zellshme dhe përshfaq aftësinë vrojtese në trajtimin e problemeve në fushën e gjuhës dhe letërsisë, duke i rrokur ato në një pamje tërësore në të gjitha dimensionet; në fonetikë, morfologji, fjalëformim, leksikë dhe stilistikë”.

Një vepër tjetër shkencore e botuar në 100-vjetorin e shtetit shqiptar është “Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës”, e përgatitur dhe redaktuar nga mr.Skender Asani, mr.Mehmet Prishtina dhe dr.Sefer Tahiri. Kjo vepër përmes dokumenteve të pabotuara më parë, të mbledhura në arkiva të ndryshme, jep fakte të reja mbi Hasan Prishtinën, këtë veprimtar gjigant, i cili bëri vepra të mëdha në planin gjithëkombëtar. Përmes kësaj vepre shpaloset një epokë e tërë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, përpjekjet për çlirim nga pushteti osman dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Siç do të pohojë Prof.dr Blerim Reka “Dokumentet diplomatike spikasin një fakt të pakontestueshëm: Shkupi, në fillim të shekullit të kaluar ishte epiqendra e aktivitetit politik kombëtar shqiptar”.

Një vepër tjetër e rëndësishme e botuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni është vepra e prof. dr. Ramiz Abdylit me titull “Trojet lindore shqiptare në kryengritjen e përgjithshme (viti 1912)”. Siç do të theksojnë recensentët e kësaj vepre dr. Fehari Ramadani dhe dr. Qerim Dalipi “Kjo vepër është e një rëndësie të veçantë, sidomos për faktin se jep një pasqyrë të plotë të zhvillimit të kryengritjes në këtë pjesë të trojeve etnike. Autori pasqyron pozitën e vështirë të popullit shqiptar, organizmin, zhvillimin, çlirimin e Shkupit, përfundimin e kryengritjes, etj. Shfrytëzimi i dokumenteve arkivore nga arkivat e shumta e bëjnë këtë vepër të rezistueshme ndaj çdo kritike shkencore”.

Historiografisë shqiptare gjithnjë e më shumë i shtohen vepra me vlera kombëtare nga studiues të ndryshëm shqiptarë. I tillë është edhe vëllimi me dokumente me titull “Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave 1968-1981”, i autorit mr. Qerim Lita. 50 dokumentet e hulumtuara, të grumbulluara dhe të studiuara, botohen për herë të parë të plota dhe pasqyrojnë një periudhë të historisë së popullit shqiptar, e cila fare pak është ndriçuar. Ky vëllim dokumentesh nuk është një libër i thjeshtë, por një përmbledhje faktografish historiko-shkencore për njohjen e së vërtetës së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në vitin 2012 ka botuar edhe një vepër tjetër nga fusha e historisë: “Shqiptarët

e Maqedonisë-nëntor 1943-dhjetor 1943", vepër e studiuesit të historisë, mr. Fati Iseni. Në këtë vepër autori shtjellon në mënyrë shkencore një periudhë shumë të ngjeshur me ngjarje të rëndësishme të karakterit kombëtar. Ky studim paraqet ngjarjet historike në mënyrë kronologjike dhe analitike, gjatë viteve 1943-44 duke u mbështetur në burime dhe fakte të qëndrueshme dhe njëherësh është tentuar që në kuptimin e plotë të fjalës, të jetë një punim shkencor objektiv, i saktë dhe pa mos u ndikuar nga ideologjitë dhe rrymat e ndryshme politike qoftë ato të dikurshmet, apo të sotmet.

Instituti ynë ka organin e vet, revistën shkencore "Studime albanologjike", në të cilën botohen materiale nga sfera të ndryshme: gjuhësi, letërsi, folklor, etnologji, histori, studime kulturore, etj. që ndërlidhen me albanologjinë dhe përgjithësisht shqiptarët e këtyre trevave. Besojmë se revista "Studime albanologjike" luan një rol të rëndësishëm për afirmimin e vlerave të shkencave albanologjike në këto troje, duke respektuar parimet e mirënjohura metodologjike të punës shkencore. Në revistë botohen, në radhë të parë studime të cilat ngërthejnë në vete rezultatet e punës kërkimore të punonjësve shkencorë të Institutit, por edhe studiuesve të tjerë shqiptarë nga hapësira mbarëkombëtare. Në faqet e revistës "Studime albanologjike", paraqitet dhe vërtetohet vazhdimësia historike, rrjedhimisht autoktonia e shqiptarëve këtu në Maqedoni, në trevat ku jetojnë shqiptarët sot, që nga kohët më të lashta.

Jo vetëm për Institutin shqiptar një sihariq dhe ogur i mirë është dalja në dritë e revistës 'Scupi', një edicion tjetër, i cili i përfshin vetëm punimet e



prezantuara shkencore që organizohen nga Instituti. 'Scupi', asocon lashtësinë tonë në këtë pjesë të Ballkanit, andaj në numrin e parë të tij përmbledh punimet shkencore të konferencës shkencore me temë "Mbrotja e trashëgimisë kulturore shqiptare në Maqedoni".

Viti 2012, përveç që solli jubileun e madh të 100-vjetorit të shtetit shqiptar, ishte edhe përvjetor i një jubileu jo më pak të rëndësishëm: 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimnit të Gjuhës Shqipe. Në numrin 2 të 'SCUPIT' u përmblodhën punimet e konferencës në temën

“Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare”. Në këtë konferencë u lexuan 12 kumtesa shkencore nga gjuhëtarë të Maqedonisë, Kosovës e të Shqipërisë, morën pjesë dhe patën fjalë përshëndetëse edhe pjesëmarrësit e këtij kongresi në vitin 1972: Prof. dr. Remzi Nesimi, akademik Emil Lafe dhe akademik Jani Thomai.



Prof. dr. Remzi Nesimi duke i përshëndetur të pranishmit në konferencën “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare”

‘SCUPI’ i tretë më radhe përmbledh punimet e konferencës shkencore me temë “Trashëgimia kulturore dhe turizmi në Maqedoni”, që u mbajt me ndihmën e komunës së Strugës, në të cilën në mënyrë shkencore u shqyrtuan modele të reja të promovimit të vlerave tona kulturore si atraksione turistike dhe ndërvlarshmëria midis turizmit dhe trashëgimisë. Me punimet e tyre në këtë konferencë u prezantuan studiues jo vetëm të Institutit, por edhe të USHT-së, UEJL-së, Universitetit Ndërkombëtar në Strugë, ndërsa pjesë aktive e saj ishin edhe përfaqësuesit e disa komunave.

Numri i katërt i “SCUPI-t i kushtohet 100 vjetorit të shtetit shqiptar, përkatësisht punimeve të konferencës shkencore me temë ‘Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës’ që u mbajt në Shkup më 13 dhe 14 tetor, në kuadër të manifestimeve për 100 vjetorin e flamurit dhe shtetit shqiptar.



Pamje nga konferenca "Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës"

Viti 2013

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup duke shkelur në vitin e gjashtë të funksionimit të tij si institucion publik shkencor, gjatë vitit 2013 i është përgjigjur me sukses detyrimeve ligjore, kërkesave shkencore-akademike, por edhe nevojave specifike, që ka ky institucion ndaj hulumtimit bazik dhe të thelluar të identitetit të shqiptarëve në tërësi dhe të atyre të Maqedonisë në veçanti.

Aktivitetet e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup janë shtrirë në shumë plane: në dimensionin e hulumtimit shkencor, veprimtarinë botuese dhe pjesëmarrjen e hulumtuesve shkencorë në tryeza, seminare dhe simpoziume shkencore.

Më 1 shkurt 2013 Instituti shënoi pesë vjetorin e themelimit, solemnitët i cili u mbajt në hapësirat e hotelit Holiday Inn në Shkup. Me këtë rast u ndanë mirënjohje për personalitete të ndryshme të cilët gjatë veprimtarisë së tyre kanë dhënë kontribut për kulturën dhe shkencën si dhe përfaqësimin e Institutit. Me këtë rast mirënjohje për veprimtari jetësore morën: prof. dr. Remzi Nesimi-gjuhëtar, prof. dr. Shukri Rahimi-historian dhe Alush Hamidi, veprimtar i kulturës shqiptare. Mirënjohje për kontributin e tij si nismëtar dhe hartues i elaboratit për themelimin e Institutit morri Xhabir Ahmeti. Gjithashtu mirënjohje morën edhe: prof. dr. Mirushe Hoxha-

drejtores së parë të Institutit, prof. dr. Ramiz Abdyli-drejtor i dytë i institutit dhe prof. dr. Naim Halimi-drejtor i tretë i Institutit.

Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Shefqet Zekolli, duke e prezantuar punën pesëvjeçare, theksoi se ky institut edhe pse i ri në moshë, ka arritur që të bëjë punë të cilat do t'ia kenë lakmi edhe institutet më prestigjioze dhe me përvojë më të gjatë. Por, ky rezultat është i madh kur kihet parasysh vullneti i madh i punëtorëve të institutit, të cilët kanë elan të madh që t'i ecin punët përpara. Solemnitetin e përshëndetën drejtori i Institutit të Albanologjisë në Prishtinë, dr. Hysen Matoshi, si dhe prorektori i USHT-së, dr. Fehari Ramadani.





Pamje nga shënimi i pesë vjetori i thelemimit të ITSHKSH-së

Në këtë vijë, më 17 prill të vitit 2013, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup, në vigjilje të 18 Prillit –Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Vlerave Arkeologjike, realizoi projektin “Vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe identiteti kombëtar”. Për të përcjellur deri tek gjeneratat e reja domethënien e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe lidhshmërinë e tyre me identitetin kombëtar, ligjeruan punonjësit shkencorë të ITSHKSH-së dhe bashkëpunëtorët e jashtëm shkencor. Audiencën e kësaj punëtorie e përbënin nxënësit e zgjedhur të shkollave fillore të Shkupit: “Liria”, “Imri Elezi” dhe “Kongresi i Manastirit”. Me ligjerata në tema të ndryshme nga historia, arkeologjia, kultura, folklori, gjuha dhe letërsia, u paraqitën studiuesit: dr.Skender Asani, dr.Mixhait Pollozhani, mr.Besnik Emini, dr.Izaim Murtezani, dr.Bukurie Mustafa, dr.Zeqirja Ibrahimimi dhe mr.Hidajete Azizi.

Ndërsa po në prill të vitit 2013 aktiviteti i Institutit u shtri në Manastir. Me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së rilindësit Hafiz Ali Ulqinaku (1853-1913), Muzeu i Alfabetit në Manastir, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve organizuan tribunën shkencore me temë “Rëndësia e Ali Ulqinakut në zhvillimin e alfabetit të gjuhës shqipe”. Me kumtesa u paraqitën studiues nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup,

Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë. Veprimtaria e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ka qenë e bujshme edhe në qershorin e vitit 2013. Në datën 3 qershor u organizua sesioni shkencor me temë: “Toponimia shqiptare në Maqedoni”. Ishin dy arsye që ndikuan në organizimin e sesionit: mungesa e eksplorimit të duhur shkencor të kësaj teme deri më tani, dhe sanksionimi me ligj i toponimisë shqiptare në Maqedoni, që nga viti 2004.

Në këtë sesion shkencor, morrën pjesë studiues të njohur të toponimisë dhe onomastikës, nga institucionet arsimore dhe shkencore shqiptare të Maqedonisë dhe Kosovës. Me kumtesa shkencore u prezantuan: Avzi Mustafa me temën “Toponimia dhe mikrotoponimia e Rekës së Epërme”, Xhemaludin Idrizi në temën “Për etimologjinë e disa toponimeve të fshatrave të rrethit të Shkupit”, Qemal Murati foli në temën “Toponimia shqiptare në arealin e Maqedonisë dhe përpjekja për ta manipuluar politikisht me këtë materie”, Begzad Balliu lidhur me “Toponiminë shqiptare në Maqedoni në studimet onomastike”, Asllan Hamiti në temën “Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni –dëshmi e autoktonisë”, Izmit Durmishi bëri “Vështrime fonetike mbi toponiminë e Pollogut të Epërm”, Ismet Osmani foli lidhur me “Toponiminë e Dërvenit të Shkupit”, Mustafa Ibrahimli rreth “Ligjërimit popullor dhe atij zyrtar të disa ojkonimeve në rajonin e Prilepit, Dollnenit dhe Krushevës”.

Ndërsa Naim Halimi foli për “Toponiminë në rajonin e Kumanovës –dëshmi për autoktoninë e shqiptarëve”, Berton Sulejmani prezantoi lidhur me “Përdorimin e toponimeve shqiptare në tekstet shkollore shqipe të botuara në Maqedoni (1981 – 1989)”, Skender Asani “Mbi disa emërtime të lagjeve të Shkupit në shek. XIX-XX”, Besnik Emini lidhur me “Toponiminë kadastrale dhe popullore të fshatit Çellopek të Pollogut”, Agron Salihu rreth “Toponimisë së fshatit Sllatinë të komunës së Tearcës” dhe Zeqirija Ibrahimli në temën “Standardizimi administrativ i toponimisë shqiptare në Maqedoni”.



Pamje nga sesiioni shkencor me temë: "Toponimia shqiptare në Maqedoni"

Instituti ka qenë i hapur për bashkëpunim me institucionet relevante arsimore dhe shkencore në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri.

Pas firmosjes së marrëveshjeve me institutet homologe në Kosovë e Shqipëri, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, nënshkroi Memorandumin e bashkëpunimit me Institutin e Historisë Nacionale të Maqedonisë. Memorandumi u nënshkrua nga drejtuesit e këtyre dy institucioneve, përkatësisht nga dr.Shefqet Zekolli dhe dr.Dragi Georgiev, në prani të ambasadorit amerikan në Maqedoni, Pol Uolers dhe ambasadores gjermane, Gurdun Shtajneker. Përmes memorandumit u vendosen bazat e bashkëpunimit institucional ndërmjet dy institutive dhe bëhen përpjekje për tejkalimin e barrierave të formave të ndryshme.

Si rezultat i këtij përcaktimi dhe gatishmërisë së institutit për debat te hapur, por të argumentuar shkencor, për herë të parë, pas 100 viteve, Kryengritja e shtatorit, ishte objekt i studimit të përbashkët të historianëve shqiptarë dhe atyre maqedonas. Simpoziumi dyditor që u mbajt më 4 dhe 5 tetor në Ohër dhe në Dibër, kishte për qëllim nxjerrjen në pah të fakteve historike nga historianë shqiptarë e maqedonas, për të zbardhur këtë ngjarje të rëndësishme kombëtare. Në këtë simpozium nga ITSHKSH-Shkup me punimet e tyre u prezantuan: Skender Asani: Dhuna e ushtruar nga ushtria serbe ndaj shqiptarëve të krahinës së Shkupit në periudhën tetor 1912-shtator 1913; Besnik Emini: Historianët shqiptarë për kryengritjen e shtatorit të vitit 1913 me rastin e shënimit të 80 vjetorit të saj;

Naim Halimi: Kryengritja e vitit 1913-vazhdim i luftës së popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar; Ardian Limani: Gazeta "Politika" për kryengritjen e shtatorit të vitit 1913.

Më 22 nëntor të vitit 2013, në Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, datë kjo që përkon edhe me përvjetorin e gjashtë të themelimit të institutit tonë shkencor, i cili nga dita në ditë shënonte suksese të reja në fushën e shkencës dhe kulturës shqiptare, punonjësit shkencorë të ITSHKSH-Shkup ishin pjesëmarrësit kryesorë në konferencën e organizuar në "Muzeun e Alfabetit Shqip" në Manastir me temë "105 vjetori i alfabetit shqip". Në këtë konferencë punimet e tyre i prezantuan: dr.Shefqet Zekolli, dr.Bukurije Mustafa, dr.Skender Asani, dr.Sevdail Demiri dhe dr.Sefer Tahiri.

Pikërisht për bashkëpunimin e suksesshëm në realizimin e projekteve të rëndësishme kulturore dhe shkencore, me rastin e festave të nëntorit, drejtuesit e Institucionit Nacional "Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe" – Manastir, i ndanë mirënjohje të veçantë Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup.

Në datën 12 dhjetor të vitit 2013 u organizua tribuna shkencore me temë: "Letërsia shqipe dhe shkolla", ku referuan njohës të mirë të kësaj lëmie nga ITSHKSH, USHT, UEJL, Universiteti i Shkupit, etj. Tribunën e shpalli të hapur drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Shefqet Zekolli, i cili theksoi se zhvillimi i letërsisë shqiptare, sikurse edhe zhvillimi i shkollës shqipe, kanë kaluar nëpër periudha të rënda kohore, të cilat kanë bartur pasojat e tyre deri në ditët e sotme. Më pas me punime shkencore u paraqitën studiuesit:

Zeqirja Neziri: Shkenca e letërsisë, programet dhe librat shkollor të letërsisë shqip(tar)e; Fatmir Sulejmani: Si mësohet letërsia në shkollë?; Agim Leka: Ligjërimi dhe mësimi i letërsisë në shkolla; Vebi Bexheti: Letërsia e munguar shqipe dhe kthimi i saj në shkollat tona; Shefqet Zekolli: Vlerat edukative të letërsisë shqipe për fëmijë; Avzi Mustafa: Mbi disa probleme të mësimin të teorisë së letërsisë dhe stilistikës gjuhësore në shkollë; Izaim Murtezani: Pozita e letërsisë gojore në tekstet mësimore (gjendja dhe perspektiva); Qemal Murati: Letërsia shqiptare dhe gjuha e tekstit shkollor;

Dr. Zeqirja Ibrahim: Letërsia shqipe në shkolla dhe ideologjia; Lulzim Murtezani: Rëndësia psikologjike e letërsisë: roli i saj në plotësimin e motivit të kuriozitetit të fëmijës; dhe Sefer Tahiri: Rinia shkollë midis letërsisë dhe mediave masive.

Këtë tribunë shkencore e përcollën edhe shumë arsimtarë të gjuhës e letërsisë shqipe, për të cilët këto ligjerata ishin të mirëpritura, me shpresë se do të ndikojnë në përmirësimin e imazhit të letërsisë shqipe në shkollat tona.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve të Maqedonisë në Shkup (ITSHKSH), gjatë vitit të kaluar kalendarik nxori nga shtypi disa botime të reja, të cilat e plotësojnë mozaikun e literaturës shkencore, sidomos në sferën e gjuhësisë dhe letërsisë shqipe. Bëhet fjalë për numrin e 7-të të revistës “Studime albanologjike”, librin “Fjalor i gabi-meve gjuhësore – Këshilla për t’u shprehur saktë dhe bukur” nga autori Prof.Dr.Qemal Murati, librin “Këngët lirike të Drinisë” nga autori Dr.Shefqet Zekolli dhe librin e punonjësës shkencore të institutit, Bukuriye Mustafa: “Rreth tipareve gjuhësore të gazetës ‘Shkupi’ (1911-1912)”.



Nga promovimi i veprës “Rreth tipareve gjuhësore të gazetës ‘Shkupi’ (1911-1912)”

Libri i Bukuriye Mustafës: “Rreth tipareve gjuhësore të gazetës ‘Shkupi’ (1911-1912)” është i pari i këtij lloji i cili trajton strukturën gjuhësore të gazetës më të rëndësishme shqipe të kohës në Vilajetin e Kosovës, gazetës “Shkupi”. Ky libër u promovua në datën 19 shtator, në të cilin promovim

foli studiuesja franceze, Evelyn Noygues, nga Instituti Nacional i Gjuhëve dhe Civilizimeve Orientale në Paris, e cila u ndal posaçërisht te rëndësia e gazetës “Shkupi” dhe kontributi i rilindësit Jashar Erebara, në botimin e kësaj gazete. Autorja e librit, Dr.Bukurije Mustafa, tha se me këtë libër ka dashur që të nxjerr në pah veçantinë gjuhësore të gazetës “Shkupi”, krahas karakterit bazik të saj në fushën e publicistikës.

Ndërsa, libri “Këngët lirike të Drinisë” nga autori Dr.Shefqet Zekolli, përbën një studim shkencor nga fusha e letërsisë dhe folklorit në anën e Drinit të Kosovës. Siç do të shprehet edhe vetë autori, motivet e ndryshme dhe atraktive të këngëve lirike të Drinisë, pasuria përmbajtësore që këto këngë mbajnë në vete, shprehjet e bukura lirike dhe vlerat e tjera të pamohueshme artistike që ato kanë, e kanë shtyrë atë që për një kohë të gjatë t’u përkushtohet këtyre krijimeve popullore të një rëndësie të veçantë. Recensentë të këtij libri janë Zeqirja Neziri nga Universiteti i Shkupit dhe Izaim Murtezani nga Instituti i Folklorit në Shkup.

Siç edhe mund të vërehet nga titulli dhe nëntitulli i librit: “Fjalor i gabimeve gjuhësore – Këshilla për t’u shprehur saktë dhe bukur” nga autori Qemal Murati, kemi të bëjmë me një botim i cili është më se i nevojshëm në kohën e sotme, kur sa më shumë shtohen format e komunikimit, aq më tepër shtohen edhe gabimet gjatë të folurit ose të shkruarit. Në këtë libër, gjenden mbi 1000 fjalë e fraza inflacioniste me forma të gabuara, të cilat duhet shmangur nga përdorimi. Duke e lexuar këtë libër, lexuesit do të befasohen sesa shumë gabojnë edhe aty ku nuk mund të gabohet. Ky tekst kryesisht analizon gjuhën e sotme që përdoret në mediat shqipe, si në gazeta e revista, radio e televizione, internet dhe në jetën e përditshme. Recensentë të këtij libri janë: Shefkije Islamaj nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Edlira Troplini nga Universiteti i Durrësit.

Instituti botoi edhe studimin monografik me titull “Said Najdeni – Hoxhë Voka dhe Hafiz Sherif Langu, të autorit, Prof.dr. Mahmud Hysa. Recensentë të librit janë Prof.dr. Xhevat Gega, Prof.dr. Agron Tufa dhe Mr. Ruzhdi Lata. Botimin e këtij libri financiarisht e ndihmoi Myftinia e Dibrës. Studimi monografik me titull "Said Najdeni–Hoxhë Voka dhe Hafiz Sherif Langu", është i një rëndësie të veçantë për ndriçimin e jetës dhe veprimtarisë së këtyre dy figurave të rëndësishme të kulturës sonë nga Dibra.

Të gjendur brenda këtyre dy kopertinave, këto dy personalitete trajtohen në dy pjesë të veçanta:në pjesën e parë studimi është përqendruar te Said Najdeni, ndërsa në pjesën e dytë bëhet fjalë për Hafiz Shefrif

Langun. Monografia në fund përmbyllet me një shtojcë me dokumente nga arkivat e ndryshme të cilat përcillen si faksimile origjinale.

Numri më i ri i revistës “Studime albanologjike”, me kryeredaktor Prof.Dr.Qemal Murati, sjellë para lexuesve tema të ndryshme dhe të reja nga sfera e gjuhës, letërsisë, historisë, folklorit, etj. Në kapitullin “Studime dhe artikuj”, radhiten tekstet e studiuesve: Qemal Murati, Zeqirija Ibrahimi, Izaim Murtezani, Shefqet Zekolli, Arben Hoxha, Yzedin Hima, Afrim A.Rexhepi, Naim Halimi, Skender Asani, Zeqirja Rexhepi dhe Avzi Mustafa. Në kapitullin “Identitete shqiptare e ballkanike”, lexojmë punimet e autorëve Gazmend Kapllani, Armand Plaka, Admirina Peçi, Sabaudin Zhuta, Sefer Tahiri dhe disa recensione nga Emil Lafe dhe Xhelal Ylli.

Gjatë vitit 2013, konkretisht në shtator, me ftesë të Institutit tonë, në vizitë në Maqedoni qëndroi studiuesja franceze, Evelyn Noygues, e cila gjatë kohë është marrë me çështjet shqiptare dhe veçanërisht me jetën dhe veprën e atdhetarit Jashar Erebara. Në bashkëpunim me ITSHKSH-Shkup, në datën 19 shtator, 2013 u organizua tribuna shkencore me temë “Klubi Shqiptar i Kumanovës (1909) dhe Jashar Erebara”.



Pamje nga ligjerata e studiueses franceze Evelyn Noygues në USHT, fjalë përshëndetëse e drejtorit dr.Shefqet Zekolli

Noygues kishte prezantime të tilla edhe në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në komunën e Dibrës dhe në Institutin tonë në Shkup. Albanologia

Noygues ligjëronte për figurën markante të rilindësit Jashar Erebara, me prejardhje nga Podujeva, i lindur në Mostar dhe i rritur në Dibër, ku ishte adoptuar në familjen Erebara.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve-Shkup në vitin 2013 u mbështetet institucionalisht nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Ka pranuar një sasi të konsiderueshme të librave dhe literaturës shkencore nga ana e këtij instituti. Bëhet fjalë për botime shkencore nga sfera e gjuhës, letërsisë, historisë, folklorit, etnologjisë, etj., të cilat janë shumë të rëndësishme për këmbimin e përvojave shkencore dhe zhvillimin e albanologjisë. Kohë më parë, edhe ITSHKSH i ka dhuruar të gjitha botimet e veta IAP-së dhe në bazë të marrëveshjes, do të shkëmbehen rregullisht të gjitha botimet vjetore të këtyre dy instituteve.

Si rjedhojë e aktiviteve të vitit 2013, u botua edhe numri 8 i revistës Studime Albanologjike dhe dy numra të revistës SCUPI, 5 dhe 6, në të cilën botohen punimet shkencore të prezantuara në konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, tribuna apo simpoziume të organizuara nga Instituti. Bëhet fjalë për numrat që u kushtohen tribunës shkencore "Toponomia shqiptare në Maqedoni" dhe asaj me temë "Letërsia shqipe dhe shkolla".

Viti 2014

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup (ITSHKSH) në vitin 2014 ka dëshmuar se tashmë është institucion i konsoliduar dhe i etabluar në kuadër të sistemit shkencor dhe arsimor të Maqedonisë, ka dhënë prova të shumta se është një institucion i hapur për bashkëpunim me institucionet shkencore të vendit dhe rajonit si dhe ka përmbushur me përpikëri planin e punës, të parashikuar në fillim të vitit që lamë pas. Që në fillim nënvizojmë faktin që të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara janë bërë realitet falë energjisë së palodhur të punonjësve shkencorë të ITSHKSH-së dhe ndihmës së pamohueshme të Komunës së Çairit, por edhe disa organizatave tjera siç është organizata e respektuar ZFD nga Gjermania, dhe Shtëpia Botuese "Logos A", pasi pa ndihmën e tyre ne nuk do të mund të lëviznim nga pika zero. Nuk ka munguar edhe mbështetja konkrete e projekteve nga Ministria e Kulturës, megjithatë meqë ITSHKSH-ja është themeluar dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, shpresuam që gjatë vitit 2015, por edhe në të ardhmen, ky dikaster të ndihmojë më fuqishëm realizimin e projekteve të

shumta, të cilat i janë dorëzuar në formë zyrtare. Në vazhdim do të referojmë lidhur me aktivitetet e realizuara.

Vitin 2014, Instituti e nisi me një udhëtim të disa studiuesve, sikur për të paralajmëruar se e pret një rrugëtim i gjatë, por jo edhe pa sfida dhe vështirësi, meqë ato na kanë përcjellë gjatë punës sonë vazhdimisht. Prej 11 deri më 22 janar të vitit 2014 tre punëtorë shkencor të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, drejtori i mëparshëm Shefqet Zekolli, drejtori aktual Skender Asani dhe asistenti hulumtues Ardian Limani, ishin pjesë e grupit prej dhjetë anëtarësh nga Maqedonia, që qëndruan në SHBA, në kuadër të programit ndërkombëtar për vizitorë dhe udhëheqës: “Ballafaqimi me të kaluarën – historia dhe politika”. Vizita është zhvilluar në disa qytete amerikane, me sponsorizim të Departamentit të Shtetit Amerikan, përkatësisht Zyrës për çështje edukative e kulturore.



Delegacioni dhjetëanëtarësh që qëndroi në SHBA

Ndoshta për shkak të simbolikës që ka godina e ITSHKSH, edhe aktiviteti i dytë lidhet me miqtë amerikanë. Gjatë qëndrimit të tij në Shkup, ish-diplomati amerikan në Maqedoni, Xhejms Pardju, realizoi një vizitë në Institut. Pardju, i cili ishte është edhe njëri nga ndërmjetësuesit kryesor ndërkombëtarë për arritjen e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, u takua me drejtuesit dhe të punësuarit e ITSHKSH-së, dhe më pas edhe para një

numri të mysafirëve të ftuar, mbajti një ligjëratë lidhur me Marrëveshjen e Ohrit dhe proceset politike në Maqedoni dhe rajon.



Ish-diplomati amerikan Xhejms Pardju, viziton Institutin

Nuk ka asnjë dyshim se Instituti ynë është mbështetës i vazhdueshëm i Muzeut të Manastirit. Në bashkëpunim me Institucionin Nacional “Muzeu i Alfabetit Shqip” në Manastir, me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, u organizua tribuna shkencore, në të cilën u përkujtua 120 vjetori i vdekjes së mësuesit Gjerasim Qiriazit. Drejtori i atëhershëm i Institutit, Dr. Shefqet Zekolli, i shoqëruar nga disa bashkëpunëtorë shkencor, foli për rëndësinë e kësaj date të rëndësishme për historinë tonë kombëtare, duke theksuar kontributin e madh të familjes Qiriazit në ngritjen e arsimit shqip. Përveç projekteve hulumtuese shkencore, Instituti synon promovimin e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve para të rinjve, me qëllim që të ruhet tradita jonë kombëtare, e kultivuar shekuj me radhë. Pikërisht për këtë qëllim në maj të vitit 2014 në ambientet e Gjimnazit “Zef Lush Marku” në Shkup u realizua projekti “Vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe identiteti kombëtar”. Me këtë rast, para nxënësve dhe profesorëve të shumtë, studiuesit e ITSHKSH-së, paraqitën tema të ndryshme dhe interesante, të cilat kryesisht kishin të bëjnë me kultivimin e trashëgimisë kulturore të

shqiptarëve në Maqedoni. Ky projekt synonte promovimin dhe afirmimin e trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve para gjeneratave të reja, sepse vetëm duke e njohur vetveten, në kushtet e globalizimit, mund t'i njohim vlerat dhe identitetin e të tjerëve. Me mjaft interesim, u përcoll edhe filmi dokumentar “Një jetë në ikje – zejet në Maqedoni”, me narrator Mr.Besnik Eminin. Në korrik Instituti ynë në bashkëpunim me Muzeun e Manastirit dhe Institutin Albanologjik në Prishtinë, në Qendrën e Kulturës në Manastir, organizuan tribunën shkencore “Rëndësia e Sami Frashërit në zhvillimin e alfabetit shqip, gjuhës dhe letërsisë shqiptare si dhe zhvillimin e vetëdijësimin e shqiptarëve”, në të cilën u trajtuan tema lidhur me kontributin historik, gjuhësor dhe letrar të këtij rilindësi. Kjo tribunë u realizua në kuadër të bashkëpunimit midis ITSHKSH-së dhe Muzeut të Manastirit, ndërsa u vendos që në të ardhmen dy institucionet të bashkëpunojnë lidhur me botimin e një reviste të Muzeut.

Në 11 shtator të vitit 2014, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, me rastin e 100 vjetorit, organizoi konferencën shkencore me temë: “Lufta e Parë Botërore, 1914-1918”.



*Ambasadori amerikan, Poll Uolers, në konferencën
“Lufta e Parë Botërore, 1914-1918”*

Organizimi i kësaj konference dhe zgjedhja e kësaj date jo pa simbolikën e saj, janë dëshmi se ne si studiues, veçmas të historisë, e kemi patjetër të jemi më vigjilentë me veprimet tona, më të ndërgjegjshëm me deklaratimet tona dhe më të guximshëm në ndërmarrjet tona, që mos të lejojmë të na përsëritet e kaluara. Maksima jonë duhet të jetë se ai që lejon t'i përsëritet e kaluara, thjesht nuk ka marrë mësim prej saj. Në hapjen e konferencës morën pjesë ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilqim Ademi, ambasadori amerikan, Poll Uolers dhe ambasadorja gjermane, Kristine Althausen.

Në dy sesione të konferencës shkencore, punimet e tyre i lexuan studiuesit: Nebi Dervishi, Sabit Syla, Qerim Lita, Rudina Mita & Besnik Bajrami, Haki Kasumi, Memli Krasniqi, Mehmet Prishtina & Sylë Zhitia, Isak Sherifi & Skender Asani, Aleksandar Stojçev, Ylber Sela, Naim Halimi, Isamedin Azizi, Sevdail Demiri, Besnik Emini & Ardian Limani. Shtatori i vitit 2014 ka qenë mjaft produktiv për Institutin tonë.

Në datën 30 shtator u organizua konferenca shkencore "Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni". Në konsiderojmë se përmes këtyre tubimeve shkencore, po dëshmohet se studiuesit tanë dhe vetë ky institucion, është etabluar si i mirëfilltë shkencor, i cili edhe në të ardhmen do të vazhdojë të realizojë projekte të tilla. Në dy sesionet e konferencës, u paraqitën 19 kumtesa edhe atë nga Fatmir Sulejmani, Naim Halimi, Mixhait Pollozhani, Skender Asani, Qemal Murati, Zeqirja Neziri, Hamit Xhaferi, Nebi Dervishi, Sevdail Demiri, Bukuriye Mustafa, Izaim Murtezani, Bexhet Asani, Afrim Rexhepi, Hidajete Azizi, Rini Useini, Afet Jashari, Arlind Farizi dhe Sefer Tahiri.

Në vitin 2014 ka ndodhur ndryshim edhe në strukturën drejtuese të Institutit tonë. Bazuar në kompetencat ligjore, Këshilli i Institutit zgjodhi Dr. Skender Asanin për drejtor të ITSHKSH-së, i cili prej datës 30.06.2014, ishte ushtrues i detyrës së drejtorit. Zgjedhja e Asanit u bë njëzëri nga të gjithë anëtarët e Këshillit, përkatësisht me 6 votat e anëtarëve të brendshëm dhe 3 votat e anëtarëve të jashtëm të deleguar nga Qeveria e Maqedonisë.

Nga aktivitetet tjera veçojmë edhe atë që u mbajt me rastin e shënimit të "Ditës ndërkombëtare të luftës kundër fashizmit dhe antisemitizmit". Në fakt Instituti në Qendrën Përkujtimore të Holokaustit në Shkup, me partnerët e vetë në 10 nëntor, 2014 nënshkroi Marrëveshjen për mirëkuptim dhe realizim të projektit "Ballafaqimi me të kaluarën – guximi qytetar në kohë të vështira". Memorandumi u nënshkrua edhe nga drejtuesit e Instituti të Historisë Nacionale në Shkup, Komunitetit Hebre në Republikën

e Maqedonisë dhe Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve të Maqedonisë. Projekti parasheh thellimin e bashkëpunimit në mes katër institucioneve, njëkohësisht të shërbejë edhe si shembull i respektimit dhe i mirëkuptimit ndëretnik dhe ndërfeetar. Nënshkrimi i këtij memorandumit paraqet shprehje të dëshirës së përbashkët për parandalimin dhe ballafaqimin me urrejtjen dhe dhunën ndaj cilitdo grupi etnik apo fetar.

Në Institut nuk janë realizuar vetëm projekte nga fusha e historisë apo trashëgimisë kulturore, por edhe nga gjuhësisë. Më 21 nëntor, 2014 i zhvilloi punimet konferenca shkencore me temë “Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë”. Më pas, punimet e tyre shkencore në konferencë i paraqitën studiuesit nga Shkupi, Prishtina e Tirana: Qemal Murati, Xhevat Lloshi, Emil Lafe, Dimitar Pandev, Ludmill Spasov, djali i profesorit të ndjerë, Bardhyl Demiraj, Haki Ymeri, Nexhip Merkuri, Bardhosh Gaçe, Naile Mala Imami, Myrvete Dreshaj – Baliu & Begzad Baliu, Kujtim Kapllani, Hysen Matoshi, Zeqirja Neziri, Agim Poloska, Asllan Hamiti, Mirushe Hoxha, Valbona Toska, Ismet Osmani, Mustafa Ibrahim, Berton Sulejmani, Bukuriye Mustafa, Hidajete Azizi dhe Zeqirja Ibrahim. Gjatë kësaj konference ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilaqim Ademi kumtoi edhe lajmin e shumëpritur nga Instituti. Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendosi të lejojë hapjen e tre programeve studimore të shkallës së magjistraturës, përkatësisht në Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe dhe Histori me marrëdhënie ndërkombëtare. Në bazë të këtij vendimi të Ministrisë në janar të vitit 2015 u shpall konkurs për regjistrimin e studentëve dhe tashmë studimet e magjistraturës kanë filluar dhe procesi arsimor po vijon normalisht dhe sipas dinamikës së parashikuar.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, ishte ndërmjetës në arritjen e marrëveshjes në mes të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve në Maqedoni, e cila marrëveshje u nënshkrua më 15 dhjetor në Shkup. Me këtë rast, u hap edhe ekspozita me dokumente dhe fotografi me temë “Nderi i njeriut”, në të cilën u prezantuan dokumente dhe fotografi për sakrificën e popullit hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Më 12 dhjetor Instituti, i përkrahur nga Qendra Informative Kulturore dhe Komuna e Çairit shënoi 35 vjetorin e ndarjes së Çmimit Nobel të Paqes, për shkupjanen shqiptare Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza. Ne po mundohemi me të gjitha mundësitë që t'i dalim borxhit Nënë Terezës për akti-

vitetin e saj human, por edhe kombëtar, sepse ajo doli nga Shkupi dhe mes saj ne dëshmojmë për autoktoninë tonë iliro-shqiptare.



*Shënimi i 35 vjetorit të ndarjes së Çmimit Nobel të Paqes, për shkupjanen shqiptare
Gonxhe Bojaxhiu*

Gjatë dhjetorit të vitit të kaluar Institutin, e vizitoi një delegacion i arbëreshëve të Italisë, i udhëhequr nga dekani i Fakultetit Albanologjik të Universitetit të Kalabrisë dhe studiues i njohur i albanologjisë, Prof. dr. Francesco Altimari. Delegacioni u prit nga stafi shkencor i Institutit dhe drejtori Dr. Skender Asani, i cili theksoi se një nga qëllimet e këtij takimi, është vënia e bazave të bashkëpunimit në mes këtyre dy institucioneve të rëndësishme nga fusha e shkencave albanologjike. Segment i veçantë i punës sonë është botimi i veprave shkencore dhe revistave në kuadër të institutit. Për herë të parë në historinë e shkencës, dy institute që trajtojnë historinë e dy popujve të ndryshëm, atij shqiptar dhe maqedonas, realizuan një projekt të përbashkët. Bëhet fjalë për botimin e përmbledhjes së kumtesave shkencore, në shqip dhe maqedonisht, në të cilën autorë shqiptarë dhe maqedonas shfaqën pikëpamjet dhe hulumtimet e tyre shkencore-historike mbi njërën nga ngjarjet e rëndësishme në historinë e vendit- Kryengritjen e shtatorit. Poashtu me ndihmën e organizatës ZFD botohet edhe

përmbledhja “Identitete”, në të cilën poashtu studiues shqiptarë dhe maqedonas shfaqin mendimet e tyre mbi identitetin, historinë dhe kulturën e vendit.

Instituti me ndihmën e Ministrisë së Kulturës ka botuar veprën shkencore “Probleme aktuale të gjuhës së sotme shqipe- E nesërmja e gjuhës shqipe përcaktohet sot, e studiuesit të mirënjohur Prof.dr. Qemal Murati. Kjo vepër si bosht të saj ka çështjet e kujdesit për gjuhën amtare, çka përbën një shqetësim të përhershëm të këtij autori. Vepra është ndërtuar si një mozaik katërpjesësh. Pjesa e parë titullohet “Gjuha si kod komunikimi dhe si kod emocional”, pjesa e dytë: “Biseda për shqipen standarde”, e treta “Mendime e meditime për gjuhën” dhe e katërta “Referenca filologjike”. Sipas profesorit Rami Memushaj kjo vepër përbën një prurje tjetër me vlerë të Prof.dr. Qemal Muratit, e cila ka për qëllim që të vetëdijesojë folësit e shqipes, por edhe shtetet shqiptare, për nevojën e mbrojtjes së gjuhës shqipe nga ndërhyrjet në kodet e saj si dhe nga shkeljet e normave të këtyre kodeve në ligjërimin e shkruar e të folur. Instituti ka botuar edhe veprën shkencore të punonjësit shkencor të ITSHKSH-së, Dr. Zeqirija Ibrahim “Interlinearis”, që përkthehet si ndërmjet rreshtave-në kuptim të titullit të kësaj vepre dhe nënkupton një libër që ka shtruar disa çështje (të ndërmjetme) të filologjisë, por jo vetëm. Në kapitullin e parë gjenden tekstet që kanë të bëjnë me gjuhën standarde në Maqedoni, pastaj vijnë disa tekste që, duke ndjekur modelin e studimeve që i ka realizuar në kuadër të gjurmimeve të tij-analizën e konektorëve të tekstit, përkatësisht të mjeteve të lidhjes së një teksti, nga qasja forenzike. Pjesa tjetër e librit të Ibrahimit ka të bëjë me disa interferime gjuhësore, stilistikën e gjuhës dhe transkriptimin e teksteve shqipe me alfabet arab.

Në vitin 2014, janë botuar dy numra, 9 dhe 10 të revistës s “Studime Albanologjike”, me kryeredaktor Prof. dr. Qemal Muratin, në të cilën studiues të ndryshëm nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, historisë, folklorit, kulturës kanë sjellë para lexuesve tema të reja dhe interesante për opinionin shkencor. Si rrjedhojë e aktiviteteve të vitit 2014 u botuan numrat 7, 8 dhe 9 të revistës SCUPI, në të cilën botohen punimet shkencore të prezantuara në konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, tribuna apo simpoziume të organizuara nga Instituti. Në numrin 7 u botuan punimet e konferencës shkencore mbi 100 vjetorin e Luftës së Parë Botërore, në numrin 8 punimet e konferencës mbi figurën e albanologut të madh Shaban Demiraj, ndërsa

në numrin 9 u botuan punimet e konferencës shkencore me titull “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”.

Gjatë vitit 2014 është bërë edhe avancimi profesional-shkencor i punonjësve tanë shkencore. Rini Useini mori titullin magjistër në fushën e folklorit, ndërsa Hidajete Azizi mori titullin doktor në fushën e gjuhësisë.

Viti 2015

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup (ITSHKSH), duke qenë tashmë një institucion i etabluar që përpiket më të gjitha energjitë e veta krijuese dhe potencialet hulumtuese, të kontribuojë në zhvillimin dhe avansimin e shkencës ndër shqiptarët e Maqedonisë dhe jo vetëm, në vitin 2015 ka dhënë kontribut të çmuar në shumë segmente. Në vijë të këtij konstatimi është përmbushja me sukses dhe përpikmëri e planit të punës, i hartuar në fillim të vitit.


Për dallim nga vitet e kaluara, kur objektivisht ka munguar mbështetja financiare nga Ministria e Arsimit, në vitin 2015 ky dikaster së bashku me Ministrinë e Kulturës kanë qenë mbështetësit kryesorë të projekteve dhe aktiviteteve shkencore të ITSHKSH-së përgjatë vitit, ndërsa duhet cekur edhe ndihma e pamohueshme e Komunës së Çairit, por edhe e organizatës së respektuar ZFD nga Gjermania.

Më 24 mars 2015, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, promovoi botimet e reja gjatë vitit të fundit kalendarik, sikurse edhe punën hulumtuese-shkencore. Bëhet fjalë për botimin e dy numrave të revistës “Studime albanologjike”, organizimin dhe botimin materialeve shkencore nga konferencat shkencore në edicionin e veçantë “Scupi” (tre numra), botimin e veprave studimore individuale të punëtorëve shkencor, pjesëmarrjen në konferenca dhe projekte tjera shkencore në vend dhe jashtë tij, etj.

Në fillim, drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, tha se Instituti po rrumbullakëson edhe një vit të suksesshëm në fushën e hulumtimit shkencor, profilimit arsimor, shtimit të botimeve të reja nga fusha e albanologjisë dhe fushën e organizimit të tubimeve shkencore.

ITSHKSH funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për çka promovimin e përshëndeti edhe ministri i këtij digasteri, z. Abdi-laqim Ademi. “Duke e vlerësuar lartë punën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, inkurajojmë punëtorët e

saj shkencor, që të vazhdojnë edhe më me profesionalizëm t'i qasen hulumtimit të trashëgimisë sonë kulturore e historike, për çka ka nevoja të shumta. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, brenda mundësive të veta, është në dispozicion të këtij instituti, sikurse edhe institucioneve të tjera arsimore-shkencore në vend, për të përkrahur nismat dhe projektet që kanë impakt të rëndësishëm në shoqëri”, u shpreh ministri Ademi.



Në vitin 2015 kanë vijuar me sukses të plotë studimet pasdiplomike në programin studimor Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Gjenerata e parë ka ndjekur semestrin e tretë, ndërsa gjenerata e dytë ka ndjekur semestrin e parë. Në mesin e kandidatëve ka kapacitete nga të cilat priten rezultate shumë pozitive shkencore-hulumtuese.



Gjenerata e parë e studentëve të ITSHKSH-së dhe një pjesë e stafit

Më 12 mars Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, organizoi tribunën shkencore në 100 vjetorin e Luftës së përgjakshme të Çanakalasë, ku edhe shqiptarët dhanë kontributin e tyre me

pjesëmarrje masive. Historiani i njohur shqiptar Nebi Dervishi. dhe historiani nga Turqia, Ebu Bekër Sofleu paraqitën pikëvështrime të ndryshme mbi këtë luftë. Sipas të dhënave të prezantuara, në këtë luftë morrën pjesë rreth 35 mijë shqiptarë. Historiani turk sqaroi se 90% prej tyre humbën jetën në luftë, ndërsa atyre që mbijetuan iu ofruan pasuri dhe tokë, por ata nuk pranuan, sepse lufta e tyre ishte luftë për ideale, që dëshmon madhësinë e shqiptarëve si popull.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Shoqatën e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë, më 4 prill të vitit 2014 shënuan 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës shqipe “Flaka e Vëllazërimit”. Me këtë rast, në ambientin e Institutit, u hap ekspozita me disa fotografi – imazhe të gazetës “Flaka” ndër vite, ku edhe u zhvillua një debat i ngjeshur lidhur me kontributin e kësaj gazete. Në pjesë e madhe e protagonistëve kryesorë të gazetës “Flaka”, iu përgjigjën ftesës së ITSHKSH- Shkup për pjesëmarrje në tribunë. Skender Asani, drejtor i ITSHKSH, tha se gazeta “Flaka” është kontinuitet i zhvillimit të shtypit shqiptar dhe se kjo gazetë është trashëgimi kulturore e historike e shqiptarëve të këtyre trojeve.



Tribunë për shënimin e 70 vjetorit të numrit të parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”

Një referat historik për 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, në emër të Këshillit organizativ paraqiti punonjësi shkencor i ITSHKSH-së, Sevdail Demiri, i cili tha se në vend se ky përvjetor i 70-të të shënohej me akademi solemne dhe me një format më festiv nga vetë udhëheqja e gazetës, sot po shënohet në mënyrë modeste –

përkujtimore nga Instituti dhe dy shoqata respektive. Ndërsa, Naser Selmani, në emër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, i dorëzoi mirënjohje post mortum Petro Janurës – kryeredaktorit të parë të gazetës, të cilën e pranoi i nipi i tij, Petro Janura. Më pas, në debat morën pjesë ish-kryeredaktorët e gazetës, Fejzi Bojku, Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Daut Dauti, ish-redaktorët e gazetarët Halil Zendeli, Shkëlzen Halimi, Nazif Zejnullahu, Mixhait Pollozhani, Tahir Zajazi, Xheladin Murati, Mustafa Peza, Enver Shala, Abdurrahman Kurtishi, studiuesi Blerton Sulejmani, etj. Gazeta “Flaka e Vëllazërimit” dhe revistat e saj “Fatosi” dhe “Gëzimi”, u vlerësuan si trashëgimi kulturore e historike e shqiptarëve të Maqedonisë. Një nga konkluzat e debatit ishte, që të shqyrtohet seriozisht mundësia e ruajtjes së asaj që ka mbetur pa u zhdukur deri tani. Një punë shumë e rëndësishme dhe e mundur të realizohet, është dixhitalizimi i plotë i gazetës, për ta parandaluar shkatërrimin e plotë të arkivit të saj që në gjendje jo shumë të mirë, gjendet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Shkupit. Çështja e rikthimit në jetë të emrit të “Flakës”, gjithashtu ishte një impenjim serioz, që kërkon njerëz të fortë dhe të vendosur për të ruajtur vlerat tona.

Prilli i vitit 2015 ka qenë muaj i frytshëm për Institutin. Më 20 prill në Gjimnazin e Tetovës, para gjimnazistëve u zhvillua punëtorja “Promovimi i trashëgimisë kulturore të shqiptarëve para të rinjve”. Udhëheqësi i projektit, Dr. Sefer Tahiri, theksoi rëndësinë e njohjes së rinisë tonë me pjesë shumë të rëndësishme të trashëgimisë tonë kulturore e shpirtërore, të cilat dita – ditës po humbin gjurmë. Më pastaj para gjimnazistëve të vitit të katërt, u referuan këto tema: dr. Sevdail Demiri- “Shtypi shqiptar në Maqedoni, si trashëgimi kulturore”; dr. Zeqirja Ibrahim- “Gjuha dhe letërsia shqipe, pjesë e rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe identitetit të shqiptarëve”; prof. dr. Bukuriye Mustafa- “Lojërat popullore”; prof.dr. Izaim Murtezani- “Karnevali i Bozovcës” dhe

– dr. Hidajete Azizi- “Rëndësia e emrave vetjakë”. Po ashtu u shfaq edhe filmi dokumentar -“Një jetë në ikje” (zejet në Maqedoni).

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar që ka me Institutin gjerman “Georg Eckert” dhe Institutin e Historisë Nacionale të Shkupit, më 3 dhe 4 qershor organizoi konferencën shkencore “Historiografia dhe mësimdhënia e historisë në rajonet gjuhësore të sllavishtes jugore dhe shqipes”.

Konferenca, e para e këtij lloji në rajon kishte për qëllim hulumtimin, studimin dhe identifikimin e problemeve në lëmin e historiografisë dhe mësimdhënien e lëndës së historisë në rajonet sllavofolëse dhe shqipfolëse. Në mesin e shumë studiuesve të njohur të historisë nga rajoni e bota, morri pjesë edhe Prof.dr.Natali Klajer nga Parisi. Nga ITSHKSH, në këtë konferencë, punimet e tyre i prezantuan Dr.Skender Asani dhe Dr.Besnik Emini.

Nën patronatin e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Prishtinë më 5 qershor u organizua konferenca shkencore: "Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare". Bashkëorganizatorë të kësaj konference ishin tre institutet shqiptare në trekëndëshin Prishtinë-Tiranë-Shkup: Instituti i Historisë i Prishtinës, Instituti i Historisë i Tiranës dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Kjo ishte hera e parë që në këtë format bashkëpunuan tre institucionet shkencore në hapësirën shqiptare. Në këtë konferencë morrën pjesë gjithsej 24 studiues të njohur të historisë sonë kombëtare, ndërsa nga ITSHKSH me kumtesë u paraqit Dr.Sevdail Demiri. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr.Skender Asani ishte pjesë e Këshillit organizues të konferencës.



*Pamje nga konferenca "Isa Boletini në Lëvizjen
Kombëtare Shqiptare" - Prishtinë*

Më 26 gusht të vitit 2015 në ITSHKSH-Shkup u mbajt tribuna shkencore me temë "Shqiptarja nga Shkupi - Nënë Tereza". Punimet e tyre shkencore në këtë tribunë i paraqitën: dr. Don Lush Gjergji: Fuqia e fesë dhe

frymëzimi i dashurisë– Nëna Tereze; dr. Skender Asani: Pronësia e shtëpisë së Gonxhe Bojaxhiut (Nënë Terezës) – dëshmi për shqiptarësinë e sheshit të Shkupit (dokument); prof. dr. Nebi Dervishi: Nënë Tereza– nobelistja shqiptare nga Shkupi (me rastin e 105 vjetorit të lindjes-26 gusht 1910-2015); dr. Sefer Tahiri: Tendencat për zvetënimin e identitetit etnik shqiptar të Gonxhe Bojaxhiut; Fadil Curri: Pse po struket historia shqiptare e Shkupit? dhe Don Viktor Sopi: Nënë Tereza në vizionin e personaliteteve botërore.

Shtatori si zakonisht pas muajve të verës, gjithmonë është produktiv në planin e realizimit të aktiviteteve të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup.

Më 11 shtator, në ditën e tragjedisë së popullit amerikan dhe luftës kundër terrorizmit global, në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, u shfaq njëri nga projeksionet më të mira dokumentare – filmike, që flet për kontributin e madh të shqiptarëve në shpëtimin e mijëra familjeve hebreje gjatë Luftës së Dytë Botërore - filmi “BESA: Premtimi”. Atë e ndoqën ambasadori amerikan, Xhes Bejli, i cili edhe pati një fjalë rasti, ku çmoi lartë virtytin e hershëm të shqiptarëve për fjalën e dhënë, si dhe shumë ambasadorë tjerë, krerë fetarë, politikë dhe shtetërorë. Të pranishmit u pëshëndetën edhe nga drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, drejtori i Qendrës Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, Goran Sadi-kario, kryetaja e Komunitetit Hebraik në Maqedoni, Berta Romano- Nikoliq dhe nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilaqim Ademi.

Mjaft emocionale ishte paraqitja e znj. Ita Faraxhi nga Izraeli, familja e së cilës ishte nga Shkupi, ndërsa kishte ikur në Shkodër të Shqipërisë për të shpëtuar nga nazistët. Ate kishte lindur, ishte pagëzuar me emrin Drita dhe kishte jetuar dy vjet në një familje shqiptare. Ngjarja u organizua nga Qendra Memoriale e Holokaustit të Hebrenjve në Shkup dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Komunës së Çairit.

Në vazhden e bashkëpunimit midis ITSHKSH dhe Qendrës Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, në muajin tetor drejtori i Institutit, Dr. Skender Asani, i dorëzoi Qendrës gjithsej 729 dokumente dhe 49 fotografi. Materiali i pasur arkivor është hulumtuar në Arkivin Qendror të Shqipërisë në Tiranë, nga një ekip i studiuesve të këtyre dy institucioneve nga Shkupi. Dokumentet dhe fotografitë në fjalë, flasin për historinë e shpëtimit të hebrenjve nga ana e shqiptarëve të Shkupit e Kosovës, gjatë

periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Ato paraqesin një thesar të çmuar të historiografisë shqiptare e botërore, duke dëshmuar për një virtut të lartë dhe shumë të çmuar për shqiptarët historikisht, siç është besa, e cila i shpëtoi qindra e mijëra hebrenj nga nazizmi.



Promovimi i filmit “BESA: Premtimi” në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup

Ndryshe, shqiptarët shpëtuan të paktën 3280 hebrenj gjatë Holokaustit. Gjatë viteve 1933-1944, Shqipëria shpëtoi jo vetëm hebrenjtë vendas, por edhe të gjithë ata që mundën ta arrinin Shqipërinë nga vendet e tjera të Europës. Andaj, si mirënjohje për këtë, Institucioni “Yad Vashem” në Jeruzalem, deri më tani ka njohur zyrtarisht 69 shqiptarë si “Fisnikë të Kombeve” në shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit.

Më 1 dhjetor në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve nga Maqedonia, u hap ekspozita me temë: “Ballafaqimi me të kaluarën – guximi qytetar në kohë të vështira”. Përmes kësaj ekspozite me 34 fotografi dhe dokumente, për herë të parë u pasqyruan realitetet e bashkëpunimit mes komuniteteve në Maqedoni, në rrafshin human, në periudhat para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Më 14 dhe 15 shtator në Shkup u mbajtën punimet e konferencës shkencore me temë: “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë

ndërmjet dy luftërave botërore". Konferenca u mbështet financiarisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Konferencën e hapi ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilqim Ademi, i cili tha se mbështetja e kësaj konferencë shkencore kishte synimin që të dalin në pah të vërteta të reja historike që do ta begatojnë mozaikun historigrafik për Shkupin.

Ndërsa, drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Dr. Skender Asani, tha se kjo është hera e parë që në mënyrë shkencore hulumtohet kjo periudhë e ndjeshme historike. Fjalë përshëndetëse patën edhe drejtori i Institutit të Historisë në Tiranë, Akademik Beqir Meta, drejtori i Institutit të Historisë në Prishtinë, Prof.dr. Sabit Syla dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof.dr. Hysen Matoshi.




Punimet e konferencës shkencore: "Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore"

Punimet e tyre i prezantuan 33 studiues të njohur nga shumë qendra shkencore të vendit dhe jashtë. Në sesionin e parë u paraqitën me kumtesa këta studiues: Beqir Meta, Nebi Dervishi, Marenglen Verli, Daut Bislimi, Avzi Mustafa, Qerim Lita, Shinazi Memedi, Adnan Ismaili, Viktor Sopi, Naim Halimi, Metin Izeti, Nuridin Ahmeti, Skender Asani dhe Mehmet Prishtina. Kurse, në sesionin e dytë, me kumtesa u paraqitën këta studiues: Qemal Murati, Zeqirija Ibrahim, Albert Ramaj, Mixhait Pollozhani, Isame-

din Azizi & Agron Saliu, Lidija Gjurovska & Gabriela Topuzovska, Fadil Curri, Natasha Didenko & Albert Hani, Izaim Murtezani, Skender Lutfiu, Sefer Tahiri, Sevdail Demiri, Besnik Emini, Ardian Limani, Naser Ramadani, Taxhedin Bislimi, Murtezan Idrizi, Islam Islami & Muhamed Ali, Afet Jashari dhe Rini Useini. Në kuadër të këtij aktiviteti, u prezantua projekti: “Veshja popullore në rajonin e Karshiakës” nga Dr. Bukuriye Mustafa, mbështetur nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë.

Me rastin e festave të nëntorit dhe 50 vjetorit të vdekjes së Fan S.Nolit, Instituti më 20 nëntor organizoi tribunën shkencore me temë “Fan S.Noli – figurë emblematike për shqipen dhe shqiptarët”. Mysafir special në këtë aktivitet ishte prijësi i Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, me seli në Elbasan, At Nikollë Marku, njëri nga pasuesit e frymës kombëtare të Nolit. Ai tha se ndjehet krenar që figura e Nolit vazhdon të nderohet e kujtohet gjithkrah ku ka shqiptarë, si një njeri që gjatë gjithë jetës së tij, punoi dhe veprroi në shërbim të popullit të tij që aq shumë e deshi. Në këtë tribunë, me kontributet e tyre shkencore u paraqitën studiues të njohur të veprës së Nolit: Ali Jashari – “Për Fan Nolin dhe visarin e tij frazeologjik popullor”; Qemal Murati – “Fan Noli – ky lëvrues i madh i fjalës shqipe”; Avzi Mustafa – “Noli në mesin e shqiptarëve të Ukrainës”; Zeqirja Neziri – “Noli dhe epika gojore shqiptare”; Olger Brame – “Përdorimi i simboleve në veprën e Fan Nolit”; Mirlinda Krifca – “Noli mes mitit dhe realitetit”; Myrvete Dreshaj – Baliu & Begzad Baliu – Studimi i Nolit dhe veprës së tij në Kosovë”; Avni Spahiu – “Vatra e shqiptarëve të Amerikës dhe Noli”; Shpëtim Çuçka – “Noli – simboli i përkthimit shqiptar” dhe Zeqirija Ibrahim – “Prifti kryeministër Fan S. Noli”.

Në vitin 2015 nga shtypi dolën botimet e reja të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Bëhet fjalë për numrin e 11-të me radhë të revistës shkencore “Studime albanologjike”, katër numra të revistës periodike “Scupi”, “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni” me autor Qemal Muratin dhe “Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor” me autor Sevdail Demirin.



Botimet e reja të Institutit

Në këtë edicion të revistës “Studime albanologjike”, lexohen punime shkencore nga 26 studiues të ndryshëm nga të gjitha trevat shqiptare, por dhe nga disa autorë të huaj nga fusha e historisë, gjuhës, letërsisë, folklorit, etj.

Numri 8 i botimit periodik të Institutit “SCUPI” përfshin punimet e konferencës shkencore “Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë”, e mbajtur më 21 nëntor 2014. SCUPI-9 boton punimet e konferencës shkencore “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”, e mbajtur më 30 shtator 2014. Numri 10 i botimit “SCUPI” ngërthen në vete kumtesat shkencore të tribunës shkencore së mbajtur më 4 prill 2015, me rastin e 70 vjetorit të botimit të numrit të parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”. Ndërsa numri më i ri i revistës periodike “SCUPI”-11, i kushtohet shqiptares nga Shkupi - Nënë Tereza. Ky botim përmban punimet e konferencës shkencore të mbajtur më 26 gusht 2015 në ITSHKSH-Shkup kushtuar kësaj figure të madhe kombëtare dhe universale.

Botimi “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni” me autor Qemal Muratin, me gjithsej 860 faqe, përmban mbi 20.000 leksema, frazeologji dhe topoleksema të mbledhura nëpër vendbanimet shqiptare të Maqedonisë. Ky fjalor është i thurur edhe me lëndë të leksikut toponimik, me emra të vendeve (rreth 5.000 topoleksema). Në lëndën e këtij Fjalori janë arkivuar dhe rreth 1.000 njësi frazeologjike, fraza idiomatike, eufemizma etj., me vlera të veçanta etnolinguistike.

Kurse, libri “Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor” me autor Sevdail Demirin, përbën një botim të veçantë shkencor të historisë së shtypit shqiptar në Maqedoni, ku sidomos është hulumtuar aspekti kulturor- arsimor. Këtu në radhë të parë flitet për gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, e cila ishte shenjë dalluese, me të cilën identifikohesh jo vetëm se shtypi dhe gazetaria shqiptare në Maqedoni në periudhën e caktuar, por gati se i gjithë zhvillimi kulturor-arsimor i shqiptarëve, i cili pasqyrohet në këtë gazetë. Pjesë e hulumtimit në këtë libër janë edhe revistat për fëmijë “Gëzimi” dhe “Fatosi”, si dhe revista për art, shkencë dhe për kulturë “Jehona”. Këto tre botime janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, në bazë të programit nacional për kulturë të vitit 2015.

Më 15 prill 2015 Instituti promovoi librin për gjenin e gjeodezisë evropiane e botërore, me origjinë shqiptare, Karl Gega nga historiani austriak Wolfgang Straub, i përkthyer në gjuhën shqipe. Ndryshe, Karl Gega, ishte inxhinier i talentuar, i cili i kaloi kufijtë e fantazisë së njerëzimit. Karl Gega ishte me origjinë shqiptare. Lindi në Venedik më 10 janar 1802. Prindërit i kishin lindur në Kallmet të Lezhës. Vdiq në Vjenë, më 14 mars 1860.

Më 11 qershor u promovuan dy veprat shkencore të Don Viktor Sopit: “Fishta, dëshmi e identitetit shqiptar”, dhe „Gjeçovi –tradita dhe qytetërimi shqiptar”. Recensionet e tyre rreth këtyre dy veprave i paraqitën studiuesit: Prof. dr. Emin Kabashi – këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Dr. Zeqirija Ibrahim – studiues dhe punonjës shkencor i ITSHKSH-së. Poashtu, një sintezë të përmbajtjes dhe rëndësisë së këtyre veprave, paraqitën edhe poeti e studiuesi Sarë Gjergji dhe shkrimtari e publicisti Fadil Curri.

Më datën 17 nëntor të vitit 2015 Ministria e Arsimit dhe Shkencës promovoi 14 tituj të rinj të librave universitar të përkthyer dhe të botuara në gjuhën shqipe. Titujt e rinj të cilët u promovuan në ambientet e Institutit ishin nga lëmia e turizmit, arteve figurative, shkencave matematiko- natyrore, transportit dhe telekomunikacionit dhe shkencave të makinerisë dhe elektroteknikës, pjesë e projektit “Përkthimi i 1000 librave shkencor dhe profesional” me të cilat studiohet në universitetet më të mira dhe më me renome në SHBA dhe Angli, kurse nga lëmia e drejtësisë edhe në Francë dhe Gjermani”.

Më datën 25 nëntor të vitit 2015 u promovua projekti i parë i përbashkët në mes dy instituteve shkencore të Shkupit e Tiranës, përkatësisht

Instituti të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Instituti të Historisë së Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë. Bëhet fjalë për botimin e librit "S H K U P I"- Konsiderata etnografike, historike, ekonomike (1942), e studiuesit dhe diplomatit të mirënjohur Hamit Kokalari, të cilin libër e redaktoi dhe përgatiti për botim Akademik Marenglen Verli. Burimi i materialit në këtë libër historik është Arkivi i Institutit të Historisë së Tiranës, fondi etnografi. Botimin e këtij projekti e mbështeti Kryetari i Komunës Çair të Shkupit, Izet Mexhiti.

Pikërisht në datën e njëjtë, pra më 25 nëntor, në shenjë të manifestimeve me rastin e festës së flamurit shqiptar, Posta e Maqedonisë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, promovuan pullat e reja postare me dy figurat e shquara të historisë kombëtare shqiptare, Ali Pashë Tepelena dhe Dr. Ibrahim Temo. Dy pullat postare publikohen në shumë letra, kartolina dhe dërgesa postare.

Në dhjetor të vitit 2015 u ngrit nisma për licencimin e lektorëve të gjuhës shqipe, nismë kjo e kahmotshme e ITSHKSH-së. Me këtë rast ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilqim Ademi vizitoi Institutin, ku u bisedua për kërkesën e Institutit për licencimin e lektorëve të gjuhës shqipe, që është një hap shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore e shpirtërore, ku bie edhe gjuha shqipe, e cila duhet të mbrohet në mënyrë institucionale.

Këtë vit ITSHKSH-së iu shtuan edhe dy doktorë shkencash. Në fushën e historisë, në Universitetin Publik në Shkup doktoroi Besnik Emini, ndërsa etnomuzikologu dhe violinisti i njohur Ermal Mehmeti doktori në studimet kulturore, duke mbrojtur doktoraturën në Universitetin privat "Evroballkan".

Viti 2016

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, si institucion shkencor me financim publik në vitin 2016 ka realizuar një plan i përmbushur me shumë aktivitete në shumë plane: hulumtues- shkencor, në dimensionin e veprimtarisë botuese, në atë të organizimit të tribunave e konferencave shkencore dhe në mbarëvajtjen e studimeve pasdiplomike. Bëhet fjalë për një angazhim të të gjithë punonjësve shkencorë në shumë sfera, me qëllim të përmbushjes jo vetëm të detyrimeve ligjore, por edhe të

misionit që ka para popullatës shqiptare, identitetin e së cilës e kultivon, mbron, por edhe promovon dhe afirmon.

Instituti e ka nisur mbarë vitin 2016. Që në 22 janar në Shkup promovoi librin "Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare", i cili përmban materiale nga konferenca shkencore mbajtur më 5 qershor 2015 në Prishtinë. Në të vërtetë, ky projekt ishte fryt i bashkëpunimit në mes të Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, Institutit të Historisë – Tiranë dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Promovimin e përshëndeti pinjulli i familjes së Isa Boletinit, Gazmend Boletini, i cili theksoi rëndësinë e madhe të këtij libri për historiografinë shqiptare. Më tej, rreth rëndësisë së konferencës shkencore dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, folën drejtori i Institutit të Historisë së Prishtinës, Prof.dr.Sabit Sylja, dhe drejtori i ITSHKSH-së, Dr.Skender Asani, të cilët çmuan lartë figurën e Isa Boletinit dhe këtë përmbledhje me materiale shkencore historike. Ndërsa, më hollësisht rreth përmbajtjes së librit, folën Prof.dr. Sabile Keçmezi - Basha nga Instituti i Historisë së Prishtinës, dhe Dr.Sevdail Demiri nga ITSHKSH-Shkup. Në këtë libër me mbi 360 faqe, janë botuar kumtesat shkencore të 24 studiuesve të njohur shqiptarë nga të gjitha trojet etnike shqiptare, duke e ndriçuar figurën e heroit kombëtar Isa Boletini në më shumë aspekte. Libri u botua me rastin e 100 vjetorit të rënies së Isa Boletinit, dhe me rastin e ngritjes së shtatores së tij në Komunën Saraj të Shkupit.

Më 2 mars 2016, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, prezantoi veprimtarinë e vetë botuese gjatë vitit paraprak. Bëhet fjalë për gjithsej 13 botime, në mesin e të cilave bëjnë pjesë botime autoriale, revista dhe botime të përbashkëta me institutet simotra.

Skender Asani, drejtor i ITSHKSH-së, tha se gjatë vitit 2015 jemi përkushtuar në veprimtarinë botuese, dhe bashkë me shumë projekte të tjera shkencore, kemi arritur që të etablohemi në mesin e instituteve të respektueshme vendore dhe ndërkombëtare. "Edhe gjatë këtij viti, ne po vazhdojmë me realizimin e programit tonë, ku kemi paraparaë disa botime nga sfera e trashëgimisë popullore, gjuhësisë, letërsisë e historisë. Me këtë rast po veçojmë konferencën ndërkombëtare për ballkanologjinë që do të mbahet kah fundi i vitit, si dhe konferencat shkencore në bashkëpunim me institutet e Prishtinës dhe Tiranës", u shpreh Asani.



Promovimi i veprimtarisë botuese për vitin 2015

Promovimin e përshëndeti sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Behixhudin Shehapi, i cili vuri në pah mbështetjen e kësaj ministrie ndaj Institutit, veçanërisht në planin e veprimtarisë botuese. Ndërsa, rreth vlerave shkencore dhe artistike të veprave të botuara, foli studiuesi i njohur nga Shqipëria, Xhevat Lloshi, i cili nënvizoi veçoritë e këtyre botimeve, si dhe kontributin e çmuar që po jep Instituti i Shkupit për pasurimin e shkencës së albanologjisë.

Sekretari shkencor i ITSHKSH-së, Sefer Tahiri, prezantoi veç e veç të gjitha botimet e realizuara gjatë vitit 2015.



Në mars në Bozovcë të Tetovës tradicionalisht u zhvillua manifestimi tradicional “Karnavalet Ilire”, në shenjë të përfundimit të dimrit dhe fillimit të stinës së verës, në bazë të traditës së vjetër pagane ilire. Me këtë rast, në

bashkëorganizim të ITSHKSH-së dhe organizatorëve të manifestimit, u zhvillua një tribunë shkencore, ku u lexuan disa kumtesa nga studiues të kësaj lëmie nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria. Referatin kryesor e paraqiti studiuesi i folklorit dhe etnokulturës shqiptare, Izaim Murtezani. Më 14 mars, në Strugë u zhvilluan disa aktivitete që lidheshin me Ditën e Verës. ITSHKSH në bashkëpunim me Shoqatën “Liqeri”, organizuan tribunën shkencore me temë “Dita e Verës – vlerë e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve”.



Promovimi i revistës SCUPI në “Karnavalet Ilire” në Bozovcë

Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, tha se vlerat tona të lashta kulturore e shpirtërore, duhet kultivuar, meqë ato janë pjesë e traditës dhe të së kaluarës sonë, janë pjesë e identitetit tonë. Gjatë tribunës shkencore u lexuan këto kumtesa: “Dita e Verës – konteksti historik dhe aktual” nga Prof.dr.Izaim Murtezani, “Dita e Verës- reliket kulturor në fshatin Patishka-Karshiakë” nga Prof. dr.Bukurie Mustafa, “Festimi i Ditës së Verës në fshatrat Veshalle dhe Bozovcë të Malësisë së Tetovës” nga Prof.dr.Vebi Bexheti, “Simbolika e Ditës së Verës në trevën e Kërçovës” nga Prof.dr.Hamit Xhaferi, “Dita e Verës në trevën e Pellagonisë” nga Prof.dr.Mustafa Ibrahim, i

“Dita e Verës në Malësinë e Sharrit të Tetovës” nga Neshat Mehmedi, “Dita e Verës – praktika e sotme në fshatrat e Strugës” nga Mr.sc.Rini Useini dhe “Rëndësia e Ditës së Verës për etnokulturën shqiptare” nga Afet Jashari.

Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 18 mars 2016 u mbajt një ligjeratë nga Prof.dr. Haki Kasumi, historian dhe kryetar i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Zhdukur në Kosovë gjatë luftës së fundit. Tema e ligjeratës ishte “Të pagjeturit – një dhimbje e madhe për Kosovën dhe njerëzimin”.

Më 29 mars, ITSHKSH, në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime Ballkanike në Edirne, në qytetin Edirne të Turqisë, në suaza të manifestimit “Ditët e Kulturës Maqedoni-Turqi”, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH)- Shkup dhe Institutit për Hulumtime Ballkanike (IHB) në Universitetin Thrakia të Edirnesë. Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i ITSHKSH, Dr.Skender Asani, dhe drejtori i IHB, Dr. Ridvan Xhanim, në prani të sekretarit shtetëror të Ministrisë së Kulturës së RM-së, Behixhudin Shehapi dhe rektorit të Universitetit Thrakia të Edirnesë, Dr.Jener Joruk.

Më 4 prill të vitit 2016 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve në Shkup, promovoi projektin e Prof.dr.Zymer Neziri: “Eposi i kreshnikëve – monument i trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në pesë vende të Ballkanit”. Bartësi i projektit, Prof.dr. Zymer Neziri nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, tha se ky projekt ka zgjatur katër vjet edhe ende vazhdon edhe më tej të rrumbullakohet. Në projekt janë angazhuar rreth 90 mbledhës të folklorit nga të gjitha trevat shqiptare. Materiali i mbledhur në terren është botuar në 15 vëllime si paralibra, të cilat bartin në vete vlera të mëdha të eposit epik shqiptar që nga kohërat më të hershme. Më pas Neziri në formë elektronike ia dorëzoi drejtorit të ITSHKSH-së, Dr.Skender Asani për nevojat e Institutit, gjithë materialet e grumbulluara të këtij projekti. Rreth eposit të kreshnikëve, folën studiuesit e njohur të kësaj fushe: Prof.dr. Zeqirija Neziri, profesor në Fakultetin Filologjik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, Prof.dr. Bukurije Mustafa, studiuese në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Prof. dr.Izaim Murtezani, studiues në Institutin e Folklorit në Shkup. Promovimin e përshëndetën edhe profesorë e studiues tjerë nga Prishtina e Tirana.



Promovimi i "Eposit të kreshnikëve", projekt i studiuesit Zymer Neziri

Më 13 prill Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Marrëveshja u nënshkrua në ambientet e ITSHKSH-Shkup, nga ana e kryetarit të ASHSH-së, Akademik Muzafer Kërkuti dhe drejtorit të ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani.

Në maj, 2016 për nder të Ditës së ngadhënjimit kundër fashizmit, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, me në krye Dr. Skender Asani, duke u paraprirë përfaqësuesve të disa institucioneve tjera të rëndësishme të Maqedonisë, qëndroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Atje u prezantuan modelet pozitive të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, si dhe vlerat historike, traditën dhe besën shqiptare, për shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kështu, më 9 maj 2016 në Uashington DC, dhe më 12 maj 2016 në Nju Jork, para opinionit publik amerikan u prezantua ekspozita me temë "Ballafaqimi me të kaluarën – Guximi qytetar në kohë të vështira". Përmes kësaj ekspozite arkivore, me 34 fotografi dhe dokumente autentike, pasqyrohen realitetet e bashkëpunimit mes komuniteteve në Maqedoni, në rrafshin human, në periudhat më të rënda të Luftës së Dytë Botërore. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, theksoi se "Përmes kësaj ekspozite dhe këtyre aktiviteteve që promovojnë paqen dhe dialogun e ndërsjellë, duam të japim porosinë se vetëm të bashkuar mund ta mundim të keqen".



Në Uashington u prezantua ekspozita "Ballafaqimi me të kaluarën – Guximi qytetar në kohë të vështira"

Më pas delegacioni vizitoi Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kongresin Amerikan, ku zhvilloi takime edhe me përfaqësues të këtyre institucioneve amerikane. Është vizituar edhe Libraria e Kongresit Amerikan, të cilës drejtori Asani i dhuroi disa nga botimet e fundit shkencore të ITSHKSH-së.

Më 1 qershor 2016, pikërisht në 70 vjetorin e mbajtjes së Kongresit II (IV) të NDSH-së, në Shkup u mbajt konferenca shkencore, në të cilën u paraqitën me kumtesa studiues nga Kosova dhe Maqedonia. Konferenca ishte fryt i bashkëpunimit mes Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë.

Në hyrje të konferencës, fjalë përshëndetëse patën drejtori i ITSHKSH – Shkup, dr. Skender Asani, drejtori i IH – Prishtinë dr. Sabit Sylja, të cilët theksuan rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, pikërisht në Shkup, këtu ku ishte njëra ndër çerdhet kryesore të organizatës NDSH. Njëkohësisht shprehën gatishmërinë, që edhe më tutje të kontribuojnë në planin shkencor, për zbardhjen e kësaj ngjarjeje me rëndësi historike për të kaluarën tonë. "Atë që e filloi NDSH-ja, në kohërat më të vështira, me një orientim të

qartë properëndimor, është obligim i gjeneratës sonë që ta vazhdojmë atë mision kombëtar”, theksoi Asani.



Konferenca shkencore për 70 vjetorin e mbajtjes së Kongresit II (IV) të NDSH-së, në Shkup

Më pas u paraqitën studiuesit me temat e tyre. E para referoi studiuesja nga Prishtina, Sabile Keçmezi-Basha, në temën “Formimi dhe veprimtaria e NDSH-së (1945-1947)”; studiuesi nga Shkupi Qerim Lita referoi në temën: “Organizimi dhe mbajtja e Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup”; Sken-der Asani foli për “Komitetin e NDSH-së për qytetin e Shkupit dhe vep-rintarinë e Ibrahim Haki-Kelmendit”; Sabit Sylja dhe Izet Miftari në kum-tesën e tyre u përqendruan në “Rezistencën kundër vendosjes së pushtetit komunist në rajonin e Shalës së Bajgores (1944 – 1947)”. Më tej, studiuesi Haki Kasumi referoi për “Veprimtarinë atdhetare të Gjon Serreçit”, kurse Daut Bislimi për “Veprimtarinë dhe ndikimin e Halim Oranës në Kongre-sin e II-të të NDSH-së”; Ibrahim Gashi poashtu nga Prishtina kishte për temë “NDSH-në në rajonin e Drenicës”; Izber Hoti për “Organizatën Nr. 2. dhe Ajet Gërgurin”; Naim Halimi u përqendrua në “Historiografinë shqip-tare dhe të hauj për dhe rreth NDSH-së”; Nuridin Ahmeti foli për “Kontri-butin e krerëve fetarë nga Kosova në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare”; Sevdail Demiri për “Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës në vitin 1946/47”, dhe Ismet Krosi u paraqit me “Dëshmi të reja për aktivitetin e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së për qarkun e Tetovës”.

Gjatë konferencës u zhvillua edhe një debat mjaft konstruktiv, i cili pati impakt në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të kumtesave shkencore, të cilat u botuan në njërin nga numrat e ardhshëm të revistës “Scupi” në Shkup. Mjaft me interes ishte pjesëmarrja e familjeve të përfaqësuesve të lartë të NDSH-së, si të Azem Maranës, Gjon Sereçit, Ajet Gërgurit, Ibrahim Haki Kelmendit, Sulë Hotlës, Qemal Skenderit, Jetish Vishit etj. Ndërsa pasditen e 1 qershorit në oborrin e Sh.F. “Liria” në Komunën Çair të Shkupit, në çerdhen e NDSH-së, u shpalos një pllakë përkujtimore në nderim të delegatëve të Kongresit II (IV) të NDSH-së: Azem Marana, Qemal Skënderi, Hasan Bilalli, Hysni Rudi, Jonuz Balla, Osman Cami, Halim Orana, Haki Taibi dhe Faik Këpuctari-Prishtina.

Më 21 korrik 2016, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup në Prishtinë nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin universitar AAB.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në bashkëpunimin me Institutin e Studimeve Shqiptare dhe Protestante në Tiranë promovoi tre vepra të rëndësishme: “Gjerasimi: predikues, iluminist, rilindës” i autorit Xhon Kuandrud; “Pengu i kaçakëve” të autorit Gjerasim Qiriazhi dhe “Jeta ime” të autores Sevasti Qiriazhi – Dako.

Ndërsa Instituti është botues edhe i veprës shkencore “Presheva në rrjedhat e historisë (shek.XX)” i autorit Ardian Emmini dhe i veprës nga fusha e studimit të folklorit “Besime popullore shqiptare -Rite e mitologji në rajonin e Kumanovës, e autorit Mumin Zeqiri.

Më 26 gusht 2016, në Shkup, pikërisht në vendlindjen e saj, në mënyrë dinjitoze u shënua ditëlindja e shkupjanes shqiptare, Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza. Fillimisht, në vendin ku ka qenë shtëpia e saj, në sheshin e Shkupit, u vunë kurora lulesh të freskëta nga disa delegacione, si nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë (SHHSHM), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH), zëvendëskryeministrat Festim Halili e Arbër Ademi, ambasadorët e Shqipërisë e Kosovës, grupet e deputeteve nga Kosova e Maqedonia, etj. Më pas, në Galerinë kombëtare të arteve “Hamami i Daut Pashës” në Shkup, u hap ekspozita me fotografi e dokumente “Shenjtoria nga Shkupi – korrespondenca”.



Ekspozita me fotografi e dokumente "Shenjtoria nga Shkupi – korrespondenca"

Ekspozita e përgatitur nga SHHSHM, në bashkëpunim me ITSHKSH-Shkup, Institutin Shqiptar në St.Galen të Zvicrës, Arkivin Shtetëror të Lucernit në Zvicër, Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar në Tiranë, Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe Shoqatën Zvicër-Shqipëri, nxjerr në pah aspekte të reja të jetës dhe veprës së shentores së ardhshme shqiptare.

Studiuesi i njohur Qemal Murati botoi veprën "Hulumtime linguistike dhe kulturë-historike në etnoregionin e Rekës së Epërme".

Është botuar edhe numri 13 dhe 14 i revistës Studime Albanologjike, në të cilën botohen materiale të larmishme nga sfera të ndryshme. Në këtë numër janë përfshirë këto punime shkencore.

Gjatë vitit 2016 janë botuar edhe dy numra të revistës shkencore periodike "Scupi". Në numrin 14 me titull "Karnavalet e Bozovcës" janë botuar punimet shkencore të prezantuara më 13 mars në Bozovcë të Tetovës, ndërsa në numrin 15 me titull "Dita e Verës" u botuan punimet shkencore të prezantuara në tribunën shkencore të mbajtur në qytetin e Strugës, me rastin e kësaj feste pagane, e cila është vlerë e trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni.

Më 21 tetor, 2016 me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit, dirigjentit dhe etnomuzikologut të njohur shqiptar, Lorenc Antoni, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH), në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë, organizoi tribunë përkujtimore, në të cilën edhe u promovua pulla postare me figurën e Lorenc Antonit. Për jetën dhe veprën e tij folën edhe përfaqësuesi i katolikëve shqiptarë të Shkupit, Anton Sereçi, pastaj Blerim Grubi, profesor pranë Universitetit të Tetovës, njëherit edhe anëtar i Filharmonisë së Maqedonisë, Ermal Mehmeti, etnomuzikolog si dhe gazetarja Dijana Toska.

Mori pjesë edhe vajza Lorenc Antonit, znj.Vilma Antoni- Bejtullahu, ndërsa në emër të familjes të pranishmit i përshëndeti dhëndri i familjes Antoni, z.Naip Bejtullahu.



Tribunë përkujtimore – promovimi i pullës postare me figurën e Lorenc Antonit

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, ishte pjesë edhe e organizimit të simpoziumit shkencor që mbahet në Korçë më 26 tetor 2016, me temë “Shkolla e vashave: foleja kombëtare”. Simpoziumi u mbajt me rastin e 125-vjetorit të hapjes së shkollës së parë të vashave në Shqipëri. Organizatorë ishin Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, në bashkëpunim edhe me Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani” dhe Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante në Tiranë. Nga ITSHKSH-Shkup, fjalë përshëndetëse pati drejtori Dr.Skender Asani, kurse me kumtesë u paraqitet Prof.dr. Qemal Murati, i cili foli në temën “Gramatikë elementare e Sevasti Qirias Dako – një libër udhëheqës për shkollat filltare”.

Më 1 nëntor u promovuan dy vepra shkencore “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore” me autor Skender Asanin dhe Tokat e liruara 1941-1944” nga Qerim Lita. Dy titujt e rinj i solli Shtëpia Botuese “Logos A” në bashkëpunim me ITSHKSH-në. Në këto dy studime dhe hulumtime historike, të cilat u promovuan në Shkup, autorët u sjellin lexuesve dokumente të një periudhe të ndjeshme historike që deri më tani kanë qenë të mbuluara nga pluhuri i arkivave të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore”, siç u shpreh autori i saj, Skender Asani, ka të bëjë me mbijetesën e shqiptarëve si dhe sulmet e ashpra të pushtuesve të ndryshëm ndaj qytetit të Shkupit. Referuesit e librit në fjalë, Nuredin Ahmeti dhe Sevdail Demiri, u shprehën se ky botim është rezultat i një pune hulumtuese disavjeçare të autorit në arkivat e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës duke hulumtuar fonde nga më të ndryshme që ruhen në këto arkiva. Libri “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore” është me dy vëllime.

Më 20 nëntor, 2016 në Shkup, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, në bashkëorganizim edhe me dy qendrat tjera albanologjike shqiptare: Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, organizoi konferencën shkencore: “75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”. Organizimi i kësaj konference shkencore përkoi me tre momente të rëndësishme të historisë së shqiptarëve të këtyre trevave: 108 vjetori i Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, 75-vjetori i hapjes së shkollave të para shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, si dhe 9-të vjetori i themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Në emër të nikoqirit të konferencës, foli drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, i cili tha se ardhja e arsimtarëve shqiptarë në këto anë, që për herë të



Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup
në bashkëpunim me Institutin Albanologjik – Prishtinë, dhe
Qendrën e Studimeve Albanologjike – Tiranë:

organizojnë

Konferencë shkencore:

“75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”



Më 20 nëntor 2016 (e diel), ora 10:00
Salla e konferencave te Hotel “Bushit” – Shkup

parë hapën shkolla shqipe dhe sollën libra shkollorë në gjuhën shqipe, për shqiptarët e Maqedonisë ishte më shumë se vetëm arsim. Punimet e konferencës i përshëndetën edhe drejtori i QSA-së së Shqipërisë, Marenglen Verli, drejtori i IA të Kosovës, Hysen Matoshi dhe drejtori i ISSHP të Tiranës, David Hosaflook. Më pas në dy seanca, mbi 15 studiues, paraqitën punimet e tyre shkencore, në të cilën e vlerësuan lartë nismën e qeverisë shqiptare të viteve 1941-44, e cila që në fillim ndërmori masa të shpejta për arsimimin e popullsisë shqiptare në Kosovë e në Maqedoninë perëndimore. Me interes u ndoqën kumtesat e historianëve dhe studiuesve, si Beqir Meta, Xhevat Lloshi, David Hosaflook, Qerim Lita, Ragip Gjoshi, Nebi Dervishi, Marenglen Verli, Hysen Matoshi, Sabile Basha, Avzi Mustafa, Xheladin Murati, Tahir Zajazi, Zeqirija Ibrahim, Skender Asani, Sevdail Demiri, Memli Krasniqi, Milazim Elshani, Daut Bislimi, Hamdi Thaçi, Nuridin Ahmeti dhe Isamedin Azizi.

Më 21 nëntor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me rastin e 9 vjetorit të Institutit, 108 vjetorit të Kongresit të Manastirit dhe 200 vjetorit të protestanizmit tek shqiptarët, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Protestante dhe Shqiptare, promovoi tre veprat e rëndësishme, që lidhen me familjen Qiriaz. Bëhet fjalë për veprat: “Gjerasimi : predikues, iluminist, rilindës” të autorit Xhon Kuandrud, “Pengu i kaçakëve” të autorit Gjerasim Qiriaz, dhe “Jeta ime” të autores Sevasti Qiriaz – Dako.

Me praninë e tij, këtë promovim e madhështoi edhe prezenca e ambasadorit amerikan në Shkup, Xhes Bejli. Në fjalën e tij drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani në fjalën e tij u shpreh se “Promovimi i këtyre veprave nuk është promovim i zakonshëm librash, por është një histori e arsimit shqiptar dhe e Rilindjes Kombëtare, duke filluar me hapjen e Shkollës së vashave, para 125 viteve dhe Kongresin e Manastirit, e sidomos në periudhat më të rëndësishme për popullin shqiptar dhe zbardhjen e të vërtetës mbi gjenocidin ndaj shqiptarëve nga fqinjët, serbët dhe grekët dhe sidomos në Konferencën e Versajës, në të cilën Sevasti Qiriaz ishte promotore e ndërlidhjes së çështjes shqiptare dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.



*Promotori - drejtori i Institutit të Studimeve Shqiptare dhe Protestante në Tiranë,
David Hosoflok*

Pas vizitave të suksesshme në disa pjesë të Kosovës, më 5, 6 dhe 7 dhjetor 2016, në Shkup erdhi Muzeu mobil i Kosovës, i cili para qytetarëve dhe nxënësve të disa shkollave fillore dhe të mesme të Komunës Çair të Shkupit, promovoi disa nga vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve. Organizator i këtij aktiviteti ishte Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup, në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës dhe Komunën Çair të Shkupit.

Më 6 dhjetor, 2016 në sallën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, u hap ekspozita e përhershme personale e piktorit me famë botërore, Omer Kaleshi. Në të vërtetë, 24 veprat artistike të Kaleshit, janë dhuratë e vetë piktorit për atdheun e tij. Një kontribut të veçantë në realizimin e këtij projekti, ka dhënë edhe Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, me angazhimin e sekretarit shtetëror, z.Behixhudin Shehapi, i cili duke çmuar lartë veprën artistike të piktorit Omer Kaleshi, tha se me këtë aktivitet rrumbulakohet “Java e Omer Kaleshit”, i cili ka shprehë dëshirën që atdheut të tij t’ia dhuron këto 24 vepra të çmueshme artistike.



Omer Kaleshi në ekspozitën personale në ITSHKSH-Shkup

Viti 2017

Viti 2017 është vit jubilar për ITSHKSH-në, pasi rrumbullakësohet 10 vjetori i tij i themelimit. Nuk ka shënim më të mirë të këtij jubileu se sa botimi i veprave shkencore, që është edhe veprimtaria bazike e ITSHKSH-së. Në 2017-tën, u botuan rreth 30 vepra të Institutit me logon e 10-vjetorit të ITSHKSH-së. Botimi i këtij cikli me logon e 10-vjetorit, filloi me dy vëllimet e reja të edicionit “Scupi”.

Ndryshe veprat tjera paraqesin libra shkencorë të fushës së historisë, gjuhësisë, letërsisë, etnologjisë, revista e botime të veçanta. Bëhet fjalë për botime shkencore, financimi i të cilave u mundësua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë. Ndër to po veçojmë: “Scupi” 16: “70-vjetori i NDSH-së së Shkupit”; “Scupi” 17: “75-vejtari i shkollave të para shqipe”; “Scupi” 18: “Festat e kalendarit popullor”; “Studime albano-logjike” – 14; “Studime albanologjike” – 15; “Monografia e ITSHKSH-së (2007-2017)”; Skender Asani, Qerim Lita: “Konti Berthold dhe çështja shqiptare”; Mumin Zeqiri: “Gjurmëve të etnokulturës shqiptare”; Mimi Farraxhi: “Jeta nën pushtimin nazist”; Qemal Murati: “Leksikon i termave linguistike dhe fjalëve të reja shqipe”; Rini Useini: “Veshjet popullore shqiptare të rajonit të Strugës”; Sefer Tahiri: “Trajtesa identitare”; Bexhet Asani: “Lirika popullore shqiptare në Maqedoni”; Izaim Murtezani: “Rite

dhe praktika magjike të ciklit jetësor”; Mixhait Pollozhani: “Monumente të kultit paleokristian në Maqedoninë Veriperëndimore”; Baki Ymeri: “Shqiptarët e Rumanisë”; Naim Halimi: “Studime historike dhe etnologjike në trojet tona etnike”; etj.

Edhe në vitin 2017, Instituti ka qenë mjaft aktiv. Më 1 mars të vitit 2017 në Bozovcë të Malësisë së Tetovës, u promovua edicioni i 14-të i botimit të veçantë periodik “Scupi”, me temë “Karnavali i Bozovcës”. Bëhet fjalë për punimet e tribunës shkencore të mbajtur një vit më parë po ashtu në Bozovcë, nën organizimin e ITSHKSH-së dhe me pjesëmarrjen e studiuesve nga Shkupi, Prishtina dhe Tirana.

Revista shkencore u promovua para një numri të madh të pjesëmarrësve, nga drejtori i ITSHKSH-së, Dr.Skender Asani, sekretari shkencor Dr.Sefer Tahiri dhe studiuesit Dr.Izaim Murtezani dhe Dr.Fatmir Sulejmani. Organizator i këtij manifestimi ishte Shoqata Kulturore “Karnavali i Bozovcës”, e drejtuar nga arsimtari Neshat Mehmedi, e cila merret me ruajtjen e riteve dhe traditës së lashtë shqiptare në këto anë.

Më datën 14 mars me rastin e shënimeve të festës së vjetër pagane, Ditës së Verës, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, u organizua tribuna shkencore “Festat e kalendarit popullor”.



Pamje nga tribuna shkencore “Festat e kalendarit popullor”.

Në hapje të tribunës, sekretari shkencor i ITSHKSH-së, Sefer Tahiri, theksoi rëndësinë e përkujtimit të këtyre festave, të cilët çdo ditë e më tepër po mbulohen nga pluhuri i harresës. Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se përmes këtyre organizimeve, ky institucion po kujdeset që traditat dhe trashëgimia jonë e pasur kulturore, të kenë vendin e merituar. Ai me këtë rast theksoi edhe rëndësinë e përkrahjes që viteve të fundit për Institutin jep Ministria e Kulturës, përmes projekteve vjetore me interes nacional.

Më pas punimet e tyre shkencore i prezantuan studiuesit: Izaim Murtezani "Festat pagane në cilësinë e riteve të kalimit"; Bukurie Mustafa "Gjur-më të kalendarit kremtues popullor me prapavijë ortodokse në fshatin Patishkë të Karshiakës së Shkupit"; Nebi Dervishi "Ritet e motmotit në Strugë dikur dhe sot", Mumin Zeqiri "Burimet ujore, rite e besime popullo-re rreth tyre me rastin e kremtes së Shëngjergjit ndër shqiptarët në Maqedoni", Mustafa Ibrahim "Rituale dhe ceremoni gjatë festës së Shën Gjergjit (Shiniergjit) në rajonin e Pellagonisë"; Emine Shabani "Etnopsikologjia dhe ritualet pagane të festave të motmotit", Arlind Farizi "Kontributi i Neshat Mehmetit dhe Fadil Sulejmanit për realizimin e manifestimit "Karnavalet ilire të Bozovcës"; Rini Useini "Religjionet e vjetra të pasqyruara në festat kalendarike popullore"; Esmije Vejseli "Festa pagane e Ditës së Verës në fshatrat e Rekës së Epërme" dhe Neshat Mehmedi "Dita e luleve dhe Shën Gjergji në Malësinë e Sharrit (festa dhe rite pagane)".

Më 26 mars 2017, në Teatrin Poshka në Strugë, u bë promovimi i edicionit të veçantë të ITSHKSH-së "Scupi – 15", me temë "Dita e Verës në Strugë". Promotorë ishte Prof.dr.Izaim Murtezani, i cili theksoi rëndësinë e këtij botimi dhe kësaj feste të lashtë pagane ndër shqiptarët. Para të pranishmëve folën edhe drejtori i Institutit, Prof.dr.Skender Asani, drejtori i Teatrit Poshka në Strugë, Prof.dr.Agim Poshka, historiani Prof.dr.Nebi Dervishi, etj. Promovimin e moderoi kryeredaktori i këtij botimi, Prof.dr.Sefer Tahiri.

Në vigjilje të Ditës ndërkombëtare kundër fashizmit, në Nju Jork të SHBA-së, më 8 maj të vitit 2017 u hap ekspozita dhe u promovua libri dokumentar trigjuhësor "Rrugëtimi – Путешествие – Journey", i autorëve Skender Asani dhe Albert Rama.

Drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, tha se nëpërmjet kësaj ekspozite dhe këtij libri dokumentar, jemi munduar për të pasqyruar ngjarjet, dëshmitë, fotografitë, dokumentet dhe materialet arkivore të Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe të rikujtojmë se sa e rëndësishme është paqja dhe sa e rëndë-

sishme është jeta e njeriut. “Fatkeqësia që i goditi hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, përveç dhimbjes që ende është e gjallë në zemrat e njerëzve, ajo shërben edhe si mësim i mirë se çfarë mund t’i ndodhë botës nëse jemi të shkujdesur. Madje, pakujdesia është armiku më i madh i historisë. Duke mos qenë të kujdesshëm, ne me indiferencën tonë i ndihmojmë dhunës, terrorit dhe vrasjeve”, deklaroi Asani.



*Në Nju Jork ekspozita dhe libri dokumentar
“Rrugëtimi – Поемное путешествие – Journey”*

Në këtë event fjalën e mori edhe punëtori i Institutit, Dr. Sevdail Demiri, gazetari Qazim Doda, etj., të cilët theksuan rëndësinë e këtij aktiviteti, që nxjerr në pah kontributin e shqiptarëve në një periudhë të caktuar historike.

Nëpër këto dokumente, shumica e të cilave u publikuan për herë të parë, përshkruhen ngjarjet dramatike të Luftës së Dytë Botërore, me theks të veçantë të territorit të sotëm të Maqedonisë, zonat e qyteteve të Shkupit, Shtipit dhe Manastirit, prej ku u mblodhën gjithsej 7.144 hebrenj apo 98% e popullatës së përgjithshme hebreje nga Maqedonia e sotme, dhe gjatë datave 22, 25 dhe 29 mars 1943, u deportuan në kampet e përqendrimit në Treblinka të Polonisë, për të mos u kthyer kurrë.

Ekspozita dhe libri dokumentar zgjuan interesim të madh në qarqet diplomatike amerikane, dhe veçanërisht brenda komunitetit shqiptar dhe hebre. Në mesin e shumë figurave publike, ishte prezente edhe ambasadorja shqiptare në Misionin e OKB-së në Nju Jork, Besiana Kadare, kryetari

i Akademisë Shqiptare-Amerikane, Dr.Skender Kodra, aktori i njohur Xhevat Limani, gazetari Qazim Doda, etj.

Gjatë qëndrimit në SHBA, drejtori i ITSHKSH, dr.Skender Asani, ishte mysafir në lajmet qendrore të VOA (Zërit të Amerikës – <http://www.zeriamerikes.com/a/3844690.html>), ku me gazetarin Ilir Ikonomi, bisedoi rreth aktivitetit kulturor në Nju Jork, dhe zhvillimeve të fundit në botën shqiptare.

Delegacioni i Institutit, Dr.Skender Asani dhe Dr.Sevdail Demiri, ishin mysafir edhe në Qendrën Kulturore Shqiptare-Amerikane në Riverdale të Nju Xhersit, ku u pritën nga shumë bashkëatdhetarë, kryesisht nga rajoni i Strugës, me të cilët bashkëbiseduan lidhur me zhvillimet e fundit kulturore, shkencore e shoqërore në Maqedoni. Kësaj qendre i dhuruan një pjesë të konsiderueshme të botimeve të fundit të Institutit si dhe promovuan librin “Rrugëtimi”.



*Librat e Institutit në Qendrën Kulturore Shqiptare-Amerikane
në Riverdale të Nju Xhersit*

107 vjetori i lindjes së nobelistes shqiptare nga Shkupi, Shën Tereza, u shënua më 26 gusht në Shkup dhe Prishtinë. U vunë kurora lulesh te pllaka përkujtimore – në vendin ku ka qenë shtëpia e lindjes së Gonxhe Bojaxhiut,

në Sheshin e Shkupit. Kurse në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” në Prishtinë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve – Shkup, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë dhe Kryepeshkvinë e Kishës Katolike të Kosovës hapën ekspozitën e titulluar “Shenjtorja nga Shkupi – korrespondenca”.

Para të pranishmëve folën sekretari shkencor i Institutin e Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Dr.Gjon Berisha, drejtori i ITSHKSH-Shkup, Dr. Skender Asani dhe përfaqësuesi Kishës Katolike të Kosovës, jetëshkruesi i Shën Terezës, Don Lush Gjergji.

Më 15 shtator, 2017, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve – Shkup dhe Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni shënuan 85 vjetorin e lindjes së historianit të shquar Prof. dr. Masar Kodra. Me këtë rast, në objektin e Institutit u hap ekspozita me dokumente e fotografi kushtuar jetës dhe veprës së prof. Masar Kodrës, përgatitur nga Mr. Çlirim Dervishi.

Në hapjen solemne të punimeve të konferencës shkencore me temë “Prof. dr. Masar Kodra – figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932 – 2003)”, folën Prof. dr. Skender Asani në emër të organizatorit, Prof. dr. Ibrahim Gashi në emër të Universitetit të Prishtinës, dhe Fatmir M. Kodra në emër të familjes. Kurse, kryetari i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve në Shkup, Abdulla Mehmeti, i dorëzoi familjes certifikatën me të cilën Prof. dr. Masar Kodrës, i jepet pas vdekjes titulli i nderit akademik.

Konferenca shkencore i zhvilloi punimet në dy seanca. Në seancën e parë, me punimet e tyre u paraqitën: Daut Bislimi “Kontributi i prof. Masar Kodrës në historiografinë shqiptare për vitet e Luftës së Dytë Botërore”; Halim Purellku “Vështrim mbi veprën “Shqiptarët e Maqedonisë në vitet e Luftës së Dytë Botërore (1939 – 1944)””; Ibrahim Gashi “Kontributi i Prof. dr. Masar Kodrës në Universitetin e Prishtinës”; Qerim Lita “Prof. Masar Kodra në dokumentet arkivore”; Jahja Drançolli – Qerim Dalipi “Vështrim punimeve të prof. Masar Kodrës për periudhën nga shek. XV e deri në vitin 1912”; Zejnulla Qyra “Kontributi i Masar Kodrës në organizimin e konferencave, tribunave e simpoziumeve shkencore në vitet 1991 – 2001, në qytetet e Maqedonisë”; Nuridin Ahmeti “Ndihmesa e profesor Masar Kodrës në përpilimin e teksteve shkollore të historisë në Kosovë”; Skender Asani – Sevdail Demiri “Prof. Masar Kodra, shembull i një shkencëtari, pedagogu dhe vizionari të mirëfilltë”; dhe Nebi Dervishi, “Prof. Masar Kodra – jeta

dhe vepra". Kurse në seancën e dytë me kumtesa u paraqitën studiuesit: Naim Haimi "Profesor Masar Kodra, historian jo vetëm i shqiptarëve në Maqedoni"; Zeqirja Rexhepi "Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare në Shqipëri në veprën "Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane" të Masar Kodrës"; Abdulla Mehmeti "Kontributi i Masar Kodrës në nismën për themelimin e Universitetit të Tetovës"; Zeqirja Idrizi "Recension veprës "Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane"; Mixhait Pollozhani "Masar Kodra, publicist dhe gazetar"; Banush Morina "Kontributi i Masar Kodrës në revistat shkencore në Kosovë"; Hamdi Mehdiu – Dushi "Kujtimet e mia ndaj personalitetit të Prof. Masar Kodrës"; Çlirim Dervishi "Shënime bibliografike të veprave të Masar Kodrës" dhe Sadri Rexhepi "Si e kam njohur Masar Kodrën?".

Më 5 tetor, 2017 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për herë të parë u hap salla imponante (kupola), me konferencën shkencore ballkanike, që iu kushtua 500 vjetorit të Reformacionit protestant, organizuar nga Instituti Ballkanik për Fe dhe Kulturë – Shkup, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante – Tiranë dhe Instituti i Historisë Nacionale – Shkup.

Hapja solemne e konferencës u bë më 5 tetor 2017, nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, i cili theksoi rëndësinë e kësaj lëvizjeje në zhvillimet e rëndësishme të historisë njerëzore. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, tha se kemi nderin që edhe ne si Institut shqiptar në Shkup, të jemi pjesë e rëndësishme organizative e këtij eventi të madh. "Me Lëvizjen protestante lidhet përkthimi i parë i Biblës në shqip, hapja e shkollës së parë të vashave në Korçë, Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, etj. Pra, kjo Lëvizje dha një kontribut të pazëvendësueshëm për iluminimin e shqiptarëve, duke u bërë një krah shumë i fuqishëm i Rilindjes Kombëtare", u shpreh Asani.

Konferenca ishte një tubim shkencor, ku rreth njëzetë teologë, historianë, sociologë dhe politologë, të ardhur nga më tepër se 15 vende, më 6 dhe 7 tetor, i paraqitën hulumtimet e tyre për ndikimin e Reformacionit protestant, me theks të veçantë në Ballkan.



Konferenca kushtuar 500 vjetorit të Reformacionit

Qëllimi i konferencës ishte që regjionalisht t'i bashkohemi përkujtimit global të 500 vjetorit të Reformacionit, të theksohet historia dhe impakti i kësaj lëvizjeje në Ballkan, të shtohen njohuritë për këtë fushë pak të njohur në historinë e Ballkanit, dhe të nxitet komunikimi edhe për të interesuarit e tjerë për këtë temë.

Më 9 nëntor të vitit 2017 në përkujtim të 79 vjetorit të Natës së Kristaltë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Shoqata "Acta Non Verba" – Shkup, në Prishtinë dhe Shkup promovuan librin dhe ekspozitën dokumentare "Rrugëtimi", nga autorët Skender Asani dhe Albert Rama. Promovimi në Prishtinë u zhvillua në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me pjesëmarrjen e shumë ambasadorëve dhe figurave të shquara nga jeta publike. "Besojmë se kjo është mënyra më e mirë për të demonstruar vullnetin tonë përkrah popujve të qytetëruar të botës për kujtimin e luftës ndërkombëtare kundër fashizmit dhe antisemitizmit. Jemi rreshtuar në taborin e civilizimeve të botës për të dhënë mesazhe paqeje dhe harmonie mes popujve, pavarësisht racës, gjuhës, fesë apo kombit", tha kryeministri Haradinaj.



*Drejtori Asani i shpjegon përmbajtjen e ekspozitës,
Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj*

Në këtë event folën edhe recensentët Mehmet Prishtina, Sevdail Demiri dhe Petrit Zorba. Bashkautorit Skender Asani, tha se është ky një angazhim për zbulimin e të vërtetave të pathëna deri më tani, për kontributin e shqiptarëve gjatë LDB-së. Dokumentet, fotografitë dhe dëshmitë janë autentike dhe paraqesin të dhëna interesante për shumë ngjarje dramatike të asaj periudhe. Në mbrëmje, libri dhe ekspozita u promovuan edhe në Qendrën Informative Kulturore në Shkup, ku veç tjerash, fjalë rasti pati edhe ambasadori i Shqipërisë në Shkup, Fatos Reka. Gjatë muajit maj, libri dhe ekspozita dokumentare trigjuhësore “Rrugëtimi – Путешествие – Journey”, u promovua edhe në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Më 20 nëntor të viti 2017 me rastin e shënimit të Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe dhe 10-vjetorin e themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup Institutin e vizitoi zëvendëskryeministri Hazbi Lika, i shoqëruar nga sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri. Zëvendëskryeministri Lika uroi drejtorin Asani dhe punëtorët shkencorë të Institutit për punën e bërë dhe angazhimin ambicioz në afirmimin e gjuhës, historisë, traditës e kulturës shqiptare në Maqedoni. Ai theksoi nevojën e vazhdimit të bashkëpunimit institucional në drejtim të zgjidhjes së të gjitha problemeve të hapura.



Zëvendëskryeministri Lika uroi 10 vjetorin e Institutit

Më pas, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë, promovoi pullën postare me portretin e Faik Konicës, me rastin e 75 vjetorit të vdekjes, si dhe pullat postare me figurat tjera kombëtare shqiptare të ekspozuara në sallën e Institutit. Fjalë rasti në këtë eveniment patën zëvendëskryeministri Hazbi Lika, drejtori i ITSHKSH-së, dr. Skender Asani dhe drejtori i Postës së Maqedonisë, Faadis Rexhepi. Ndërsa, akademik Luan Starova, mbajti një ligjëratë të thuktë rreth jetës dhe veprës së njërës nga mendjet më të ndritura shqiptare të të gjitha kohërave, Faik Konica.

Në Manastir më 21 nëntor të vitit 2017 me prezencën e kryetarit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, zëvendëskryeministrit Hazbi Lika, kryetares së Komunës së Manastirit, Natasha Petrovska, ambasadorëve, drejtuesve të instituteve albanologjike të Shkupit, Tiranës e Prishtinës dhe studiuesve të shumtë, në Manastir u hap tribuna shkencore kushtuar 109 vjetorit të Kongresit të Alfabetit të Shqipes dhe 10-vjetorit të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Kryetari Meta, zëvendëskryeministri Lika dhe kryetarja e Manastirit Petrovska, në hapjen solemne të tribunës, theksuan rëndësinë e kësaj date të madhe historike për popullin shqiptar, duke theksuar edhe nevojën më të madhe të angazhimit institucional për zhvillimin e shkencës dhe kulturës shqiptare. Më tej, fjalë përshëndetëse patën drejtori i ITSKSH-së,

Dr. Skender Asani, drejtori i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, akademik Marenglen Verli, drejtori i Institutit të Historisë së Prishtinës, Dr. Sabit Syla dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Dr. Hysen Matoshi.



Pamje nga konferenca në Manastir. Merr pjesë edhe kryetari i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Më pas, me kumtesat e tyre u paraqitën studiuesit: Valter Memisha: "Kongresi i Manastirit – ngjarje percaktuese ne rrugetimin nje komb nje gjuhe"; Sabile Keçmezi – Basha & Tefik Basha: "Binomi Motrat Qiriazi- misioni atdhetar dhe arsimor i tyre"; Sali Kadria: "Kongresi i Manastirit – Filimi i mevetesise kombetare te shqiptareve"; Avzi Mustafa: "Arif Hiqmeti, armik i përбетuar ndaj shkronjave shqipe"; Nebi Dervishi: "Shtypshkronja e parë e Kongresit të Manastirit"; Teuta Toska: "Motrat Qiriazi dhe roli i tyre në zgjimin e vetëdijes kombëtare"; Memli Krasniqi: "Raporti i Gjergj Qiriazit mbi Vilajetin e Manastirit". Ndërsa, akademik Beqir Meta dhe dr. Izaim Murtezani përгатitën konkluzionet e tribunës, të cilat do të botohen në një nga numrat e ardhshëm të revistës "Scupi". Drejtori i ITS KSH-së, dr. Skender Asani, presidentit Meta i dhuroi një pako me libra nga botimet e fundit të Institutit.

Në Ditën e Alfabetit Shqip, 22 nëntor ditën kur e kujtojmë njësimin e gjuhës shqipe, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup në bashkëpunim me Sekretariatit për Zbatimin e Marrëvesh-

jes së Ohrit, në mesin e Qeverisë së Maqedonisë kujtuan veteranët e arsimit, të gjithë ata që ndër dekada kanë qenë sy e dritë në rrugëtimin e jetës.

Drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani në fjalimin e tij para të pranishmëve tha se takimi është me një simbolikë të madhe, pasi organizohet në mesin e qeverisë, e cila në të kaluarën ka qenë famëkeqe, meqë në të janë hartuar plane dhe strategji kundër arsimit shqip, është projektuar mbyllja e shkollave shqipe, janë diferencuar ideo-politikisht, por edhe janë burgosur shumë mësues shqiptarë, ndërsa tani takimi me veteranët e arsimit mbahet në kushte të reja, kur kemi dy universitete në gjuhën shqipe dhe një institut i cili merret me kultivimin dhe afirmimin e kulturës dhe historisë shqiptare. "Dita e sotme është ditë ngadhënjimi e arsimit shqip mbi të keqen dhe mbi ata që deshën shkatërrimin e tij", theksoi Asani.

Drejtori Asani tha se në këtë festë të madhe të shkronjave shqipe, në këtë ngjarje historike, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup shënon 10- vjetorin e themelimit. Asani theksoi: "Këtë përvjetor jubilar, ne po e kurorëzojmë me shumë suksese në planin shkencor, duke organizuar me dhjetëra konferenca të karakterit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe duke prezantuar punën tonë edhe në Uashington, Nju Jork dhe në qendrat e rëndësishme rajonale dhe evropiane. Për një dekadë punë, Instituti ynë po e arrin numrin treshifror në botimin e veprave shkencore. Instituti ka nevojë edhe për autonomi më të madhe veprimi, dhe për më shumë mbështetje institucionale në aspekt të realizimit të projekteve dhe planeve të parapara hulumtuese –shkencore. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të kompensojmë mungesat më se gjysmëshekullore të përparimit tonë në shkencë e kulturë. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të ecim tutje, duke e rritur imazhin jo vetëm se të institucionit tonë, por edhe në përgjithësi të shqiptarëve kudo që janë".

Zëvendëskryeministri për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, Hazbi Lika në fjalimin e tij foli për rëndësinë e kësaj date dhe për kontributin e madh të mësuesve shqiptarë në ngritjen dhe emancipimin e kombit dhe shoqërisë.

Para Institutit, menaxhmentit, punonjësve shkencorë dhe administratës së tij gjenden shumë sfida dhe projekte, të cilat do të shtrihen në planin hulumtues-shkencor, arsimor dhe në atë të organizimit të konferencave shkencore. Synojmë që këtë vit të rrisim numrin e veprave shkencore, që do të botohen nga punonjësit shkencorë të Institutit. Konsiderojmë se në këtë mënyrë, duke vendosur nga një gur do të ndërtojmë kalanë e botime-

ve shqiptare, të domosdoshme për njohjen e vetvetes dhe më pas edhe të të tjerëve.

Çmimin shtetëror “Shën Klimenti i Ohrit” është çmimi më i lartë për arritjet shumëvjeçare në sferën e edukimit, arsimit, kulturës, artit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe përparimit të mjedisit të njeriut në sferën sociale të interesit publik të Republikës së Maqedonisë. Ky çmim për të arriturat në lëmin edukativ dhe arsimor, iu nda dy punëtorëve shkencor të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, prof. dr. Ramiz Abdylit në vitin 2009, dhe prof. dr. Naim Alimit në vitin 2017.

Sivjet, këtë çmim në sferën e edukimit dhe arsimit, e mori prof. dr. Naim Alimi, historian me një veprimtari të gjatë në këtë fushë.



Dr. Naim Alimi gjatë praminit të Çmimin Shtetëror “Shën Klimenti i Ohrit”

Më 15 dhjetor të vitit 2017 në Pogradec të Shqipërisë, me rastin e takimit të përbashkët punues mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe asaj të Shqipërisë, u nënshkrua edhe memorandumi i bashkëpunimi ndërmjet Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë. Memorandumi u nënshkrua nga drejtorët respektiv, Dr. Skender Asani dhe Dr. Ardit Bido, nën kujdesin e kryeministrave Zoran Zaev dhe Edi Rama. Objekt i këtij memorandumi janë projekte të përbashkëta hulumtuese në fushën e historisë së shqiptarëve dhe bashkësive etnike që jetojnë në të

dy shtetet, shkëmbimi i kontakteve dhe bashkëpunimi në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, ndihma në fuqizimin e kapaciteteve të kuadrit profesional dhe shkencor, fuqizimi i partneritetit me institucionet e tjera, shkëmbimi i dokumenteve dhe literaturës profesionale, si dhe shfrytëzimi i ndërsjellë i kapaciteteve materiale dhe resurseve ekzistuese. Palët synojnë të nxisin fuqizimin e bashkëpunimit, përkrahjes dhe ndihmës së ndërsjellë në shkëmbimin e dokumenteve arkivore historike, literaturës profesionale dhe revistave shkencore, të cilat do të jenë në dobi të ndërsjellë. Kjo është një nga pesë marrëveshjet e nënshkruara në Podradec ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë.



*Momenti i nënshkrimit të marrëveshjes, nën kujdesin e kryeministrave
Zaev dhe Rama*

Më 17 dhjetor Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve – Shkup, në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese “Logos-A” – Shkup organizoi konferencën shkencore me temë “Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit”.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se sot është dita kur e shënojmë përvjetorin e themelimit të Xhemijetit dhe për neve kjo është një ditë feste. Por ne kemi festë jo vetëm për këtë arsye, por edhe sepse kjo është hera e

parë që një institucion shkencor shqiptar në hapësirën shqiptare, kudo qoftë ajo, organizon një konferencë për organizatën politike "Xhemijet". Në të vërtetë, ashtu siç e kemi thënë shumë herë, Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve po dëshmon edhe në vepër se e ka me gjithë mend dhe seriozisht studimin e historisë kombëtare shqiptare të shqiptarëve të Maqedonisë, tha Asani.

Akademik Marenglen Verli, drejtor i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, theksoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, duke theksuar se me këtë po nxirret në dritë një kontribut i madh i bartësve të lëvizjes kombëtare, me në krye Ferat Dragën, në një kohë shumë të vështirë për shqiptarët.

Para punimeve të konferencës, u bë promovimi i librave të autorit Skender Asani: "Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore – 1919-1925" dhe "Dokumente per veprimtarinë politike të Xhemijetit". Për këto vepra folën studiuesit Nuridin Ahmeti dhe Sevdail Demiri.



Promovimi i veprave të dr.Skender Asanit për organizatën Xhemijeti

Në konferencën shkencore, kontributet e tyre shkencore i paraqitën referuesit nga institutet shkencore të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit: Marenglen Verli: "Profili i Ferhat Dragës në dokumentacionin shqiptar dhe serb"; Qerim Lita: "Ferhat bej Draga, prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare

të viteve tridhjeta të shekullit të kaluar”; Jusuf Osmani: “Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të kolonizimit dhe të reformës agrare në trevat shqiptare”; Hakif Bajrami: “Kongreset e Xhemijetit”; Halim Purellku: “Xhemijeti në zgjedhjet parlamentare në rrethin e Kërçovës (1920 – 1923- 1925)”; Nebi Dervishi: “Veprimtaria e Qenan Zija Manastirliut”; Zeqirja Idrizi: “Halim bej Deralla, urë lidhëse midis Xhemijetit dhe Komitetit të Kosovës”; Redžep Škrijelj: “Sandžak i Džemijet (1917-1924)”; Naim Halimi: “Xhemijeti në kujtimet e veprimtarit kumanovar Azem Hoxha”; Ismet Azizi: “Aqif Blyta – figurë kryesore e organizatës Xhemijeti”; Skender Asani: “Burimet historike rreth veprimtarisë së Xhemijetit”; Zeqirija Ibrahim: “Identiteti politik i Xhemijetit”; Jorina Verli: “Procesi i shpronësimit dhe shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia pas shuarjes së Xhemijetit”; Наташа Диденко: “Културниот и политичкиот живот на муслиманите според Глиша Елезовиќ (1918-1925)”; Nuridin Ahmeti: “Xhemijeti në historiografinë shqiptare”; Alban Dobruna: “Pjesëmarrja e Xhemijetit në zgjedhjet parlamentare të vitit 1923 në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene”; Murtezan Idrizi: “Disa burime arkivore në lidhje me themelimin dhe veprimtarinë e Xhemijetit”; Beqir Meta pati fjalën e mbylljes së konferencës.



Pamje nga konferenca kushtuar Xhemijetit

SYNIMET E ITSHKSH-së NË VITIN 2018

Para Institutit, menaxhmentit, punonjësve shkencorë dhe administratës së tij edhe në vitin 2018 dhe vitet në vazhdim, qëndrojnë shumë projekte, realizimi i së cilave nuk mund të kalojë pa sfida. Në planin hulumtues-shkencor do të synojmë të realizojmë sa më shumë ekspedita hulumtuese në rajone të ndryshme të vendit për të gjurmuar trashëgiminë tonë kulturore, shpirtërore dhe materiale, por edhe historike, por edhe do të organizojmë konferenca shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në planin arsimor synojmë dhe po përpiqemi maksimalisht që të organizojmë studime sa më cilësore pasdiplomike, duke krijuar kuadro nga lëmitë që kultivojnë identitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik të shqiptarëve. Në planin e botimeve synojmë të rrisim numrin e veprave shkencore, që do të botohen nga punonjësit shkencorë të Institutit.

Ndërsa ndaj shqiptarëve, ndaj shkencës, ndaj misionit për të cilin jemi zotuar moralisht dhe profesionalisht, në të ardhmen kemi borxh që të vazhdojmë rrugëtimin e hulumtimit shkencor për të shpalosur fakte të reja mbi etnokulturën shqiptare dhe jo vetëm, por dhe për të sjellë para opinionit shkencor kombëtar e ndërkombëtar vepra të reja, me të vetmin qëllim të zbulojmë sa më shumë të vërtetën objektive.

Konsiderojmë se në këtë mënyrë, duke hedhur nga një pikë në oqeanin e madh dhe të pafund të hulumtimeve shkencore dhe botimeve shqiptare, do të njohim vetveten, qenien tonë, kush jemi ne dhe më pas edhe tjetrin në kufijtë e Maqedonisë dhe me gjerë.

DREJTORËT E ITSHKSH-së



Prof. dr. Mirushe Hoxha, drejtorja e parë e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (nëntor 2007 - dhjetor 2008). Profesore universitare në Universitetin e Shkupit, UEJL-Tetovë, dhe viziting profesor në disa universitete prestigjioze ndërkombëtare. Ka doktoruar në sferën e shkencave humanitare, filologjike dhe ato të sigurisë, dhe ka bërë disa specializime postdoktorale. Ishte femra e parë shqiptare kandidate për Presidente e Republikës së Maqedonisë.



Prof. dr. Ramiz Abdyli, doktor i shkencave historike, ishte drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në periudhën dhjetor 2008 - dhjetor 2010. Ka punuar në Institutin e Historisë në Prishtinë, në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, profesor në Universitetin e Tetovës që nga themelimi (1994), ndërsa një periudhë të shkurtër ishte edhe rektor i UT-së. Është autor i dhjetëra librave të historisë, dhe ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca shkencore në vend dhe jashtë.



Prof. dr. Naim Halimi, ishte ushtrues i detyrës së drejtorit të Institutit, në një periudhë gjashtëmujore, dhjetor 2010 - gusht 2011. Doktor i shkencave historike, profesor dhe ish-prorektor i Universitetit të Tetovës. Autor i disa librave monografike, dhe pjesëmarrës në disa konferenca shkencore në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Prishtinë e Tiranë. Nga vitit 2009 është i punësuar në sektorin i historisë të ITSHKSH-së, dhe është zëvendëskryetar i Këshillit të Institutit.



në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Tetovës. Është autor i disa librave studimor nga fusha e letërsisë, dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore.



Prof. dr. Skender Asani, prej qershorit të vitit 2014, ishte ushtrues i detyrës së drejtorit, kurse prej tetorit të vitit 2014, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, e zgjodhi drejtor. Është doktor i shkencave historike, autor i disa librave shkencor historik që kryesisht i kushtohen Shkupit, dhe pjesëmarrës aktiv në shumë konferenca shkencore në vend dhe jashtë. Punëtor shkencor i ITSHKSH-së është që nga viti 2008, ndërsa udhëheq edhe me Shoqatën e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni.

TË PUNËSUARIT AKTUAL TË ITSHKSH-së (2017)

Kuadri shkencor:




-**Qemal Murati** - Doktor i shkencave filologjike, këshilltar shkencor në sektorin e gjuhës shqipe.



-**Naim Halimi** - Doktor i shkencave historike, bashkëpunëtor i lartë shkencor në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike.



-**Zeqirija Ibrahimi** - Doktor i shkencave filologjike, bashkëpunëtor i lartë shkencor në sektorin e gjuhës shqipe.



-**Bukurie Mustafa** - Doktore e shkencave filologjike, bashkëpunëtore e lartë shkencore në sektorin e gjuhës shqipe.



-**Safer Tahiri** - Doktor i shkencave të komunikimit, bashkëpunëtor i lartë shkencor në sektorin e lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes shqiptarëve dhe maqedonasve me popujt e tjerë të rajonit.



-**Skender Asani** - Doktor i shkencave historike, bashkëpunëtor i lartë shkencor në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike. Aktualisht drejtor i Institutit




-**Sevdail Demiri** - Doktor i shkencave historike, bashkëpunëtor i lartë shkencor në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike. Aktualisht kryetar i Këshillit të Institutit.



-**Hidajete Azizi** - Doktore e shkencave filologjike, bashkëpunëtoresh shkencore në sektorin e gjuhës shqipe.



-**Besnik Emini** - Doktor i shkencave historike, bashkëpunëtor shkencor në sektorin e lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes shqiptarëve dhe maqedonasve me popujt tjerë të rajonit.



-**Ermal Mehmeti** - Doktor shkence në studimet e kulturës, bashkëpunëtor shkencor në sektorin e lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes shqiptarëve dhe maqedonasve me popujt tjerë të rajonit.



-**Agron Salihi** - Magjistër i shkencave demografike (doktorant), asistent hulumtues në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike.



-**Ardian Limani** - Magjistër i shkencave historike (doktorant), asistent hulumtues në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike..



-**Muharrem Jahja** - Magjistër i shkencave historike (doktorant), asistent hulumtues në sektorin e lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes shqiptarëve dhe maqedonasve me popujt tjerë të rajonit.



-**Rini Useini** - Magjistër i folklorit (doktorant), asistent hulumtues në sektorin e etnologjisë, historisë së artit dhe arkitekturës popullore.



-**Murtezan Idrizi** - Magjistër i shkencave historike (doktorant), asistent hulumtues në sektorin e historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike.

Kuadri administrativ:



Blerim Qaili
Sekretar i Institutit




Ganimete Ramadani
Bibliotekiste



Arife Kovaçi
Sekretare teknike



Nexhati Dema
Vozitës




Haxhere Osmani
Përgjegjëse e financave



Elham Bislimi
Këshilltar juridik



Nebehate Bajrami
Punëtore teknike



Hizer Asani
Roje

VLERËSIME DHE URIME PËR PUNËN E ITSHKSH-së

-Kam kënaqësinë të përshëndes këtë Institut të ri në 10-vjetorin e themelimit. Është një përvojë ende modeste, përkundër sfidave dhe përgjegjësi të tepër serioze që ka përpara. Jam i prirur t'i referohem simbolikës së momentit të themelimit, që përkon me 99-vjetorin e Kongresit të Alfabetit Shqip të Manastirit – një shkëndijë drite dhe iluminizmi në një hapësirë shqiptare me nivel etje të lartë. Janë një sërë brezash qysh atëherë, që me përkushtim, me atdhedashuri, dhe duke marrë dritë nga Europa e kulturës dhe e shkencës, ngritën gradualisht kontribute shtresa-shtresa të shkencave albanologjike në hapësirën shqiptare, nga breza studiuesish shqiptarë.

Shkencat albanologjike janë bërë tashmë të tilla dhe ne duhet ta mbajmë dhe ta baritim më tej këtë pasuri të pararendësve tanë. Ndërsa për ne është kënaqësi që ta ndajmë këtë mision me një institut të ri si tuaji, pasi së bashku mund të bëjmë më mirë, është njëkohësisht edhe përgjegjësi para popullit, para kombit.

Me urimet me të mira në 10 vjetorin e themelimit të Institutit Tuaj.

**Akademik Muzafer Korkuti,
Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**

-Themelimi i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 2007, ishte zhvillim i rëndësishëm për albanologjinë përgjithësisht dhe veçmas për shqiptarët në Maqedoni. Me gjithë vështirësitë e shumta nëpër të cilat ka kaluar si institucion në themelim, me mungesën permanente të objektit, me numrin e paktë të shkencëtarëve dhe pa ndonjë përkrahje të duhur institucionale, ndonjëherë edhe me obstrukcione të çuditshme politike, ky Institut ka dëshmuar nevojën për studime lidhur me kulturën dhe të kaluarën e shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë e më gjerë. Gjithashtu them se, në sajë të përpjekje të mëdha të punonjësve të tij, ITSHKSH-ja ka dhënë dëshmi të një pune të suksesshme hulumtuese-shkencore, veçmas viteve të fundit. Mund të thuhet se tanimë kemi një institucion të mirëfilltë kërkimor-shkencor, i cili i ka të gjithë parametrat identifikues si i tillë dhe që mund të prosperojë edhe më tej.

Instituti Albanologjik ka pasur nderin që të jetë institucion partner me këtë Institut në disa veprimtari shkencore. Megjithatë, Memorandumi i bashkëpunimit na

ofron mundësi edhe për më shumë punë të përbashkëta në të ardhmen. Në emër të punonjësve të Institutit Albanologjik, dua t'i përgëzoj kolegët tanë, drejtuesit dhe punonjësit e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, për përpjekjet e jashtëzakonshme me qëllim të krijimit të kapaciteteve institucionale albanologjike në Maqedoni, për rezultatet e arrira deri tani dhe për vendosmërinë që kanë shfaqur në drejtim të krijimit edhe të një qendre të rëndësishme referenciale për studimet shqiptare.

Prof. dr. Hysen Matoshi,
Drejtor i Institutit Albanologjik – Prishtinë

-Themelimi i ITSHKSH në vitin 2007 si institucion i rëndësishëm publik shkencor, ku që nga viti 2014 janë akredituar edhe studimet pasuniversitare në disa degë, përbën një eveniment për Republikën e Maqedonisë në përgjithësi dhe një arritje të merituar për shqiptarët në veçanti. Ecuria e këtij institucioni, krahas gjashtë institucioneve analoge në Maqedoni, ndonëse jo pa vështirësi e pengesa të llojllojshme, dëshmon për një startim me shumë dëshirë e ambicie. Instituti tashmë ka studiues me përvojë, publikon dy revista periodike ("Studime Albanologjike" dhe "Scupi"), ka realizuar botimet e para në fushat e rëndësishme të gjuhës e të letërsisë, të historisë e etnologjisë, të artit, arkitekturës, kulturës etj. dhe po përpiqet të shtojë urat e bashkëpunimit në rrafsh kombëtar e ndërkombëtar. Krijimi i një arkivi të specializuar, pasurimi i bibliotekës, specializimi e kualifikimi i personelit shkencor e ndihmës, zgjerimi i gamës së botimeve cilësore me parametrat shkencorë më bashkëkohorë mbeten sfidat e së ardhmes, që besoj se ITSHKSH do t'i përballojë me sukses. I uroj ITSHKSH-së rrugë të mbarë!

Akademik Marenglen Verli
Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë

-Në dhjetë vitet e kaluara Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni ka pasur bashkëpunim të frytshëm dhe intensiv në kuadër të disa projekteve, nga të cilat dolën disa konferenca, botime dhe ekspozita të përbashkëta. Ky bashkëpunim tregoi se Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni po rritet në institucion serioz dhe i res-

pektuar shkencor, me të cilin mund të jetësohen edhe projekte të mëdha. Përkushtimi, ambicioziteti dhe angazhimi i të punësuarve në Institut për kryerjen e detyrimeve të tyre janë dëshmi se në të ardhmen ky institucion edhe më shumë do të përparojë, duke e rritur autoritetin e etij dhe ruajtur pozitën e anëtarit serioz dhe të respektuar të mjedisit akademik institucional në Republikën e Maqedonisë. Duke ua uruar jubileun e 10vjetorit u dëshiroj suksese të reja dhe bashkëpunim më të madh të përbashkët në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Akademik Dragi Gjorgiev
Drejtor i Institutit të Historisë Nacionale – Shkup

-Më vijnë ndërmend shumë fjalë, kur mendoj për ITSHKSH-në: cilësi, guxim, pasion, optimizëm, iniciativë etj. Ky institut, i cili punon për të ndriçuar trashëgiminë e shqiptarëve, tani është bërë vetë pjesë e qenësishme e kësaj trashëgimie. Si Klubi “Bashkimi” në fillim të shekullit XX, i cili u dallua për punë, e jo për fjalë, kështu shquhet edhe ITSHKSH-ja në fillim të shekullit XXI. Është një forcë bashkuese në rajon, një zë i arsyeshëm, një promovues i paanshëm i vlerave të përbashkët, një shoqëri historianësh që dinë si bëhet shkenca.

David Hosaflook
Drejtor i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, Tiranë

-Institut i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, është një nga projektet më të rëndësishme kombëtare, projekt që shpreh nevojën e kahmotshme të shqiptarëve të këtushëm për ta shprehur angazhimin dhe përpjekjen institucionale në ruajtjen dhe në dëshmimin e identitetit kombëtar. Thënë shkurt, ky Institucion është pararoja e pathyeshme e këtij identiteti, është kështjella grandioze dhe e pamposhtur e vlerave tona materiale dhe shpirtërore gjithëkombëtare. Rrezet që bien mbi këtë “kështjellë të kristaltë” përthyhen duke reflektuar kolorit mahnitës të vertikales së identitetit tonë. Çdo punë, çdo angazhim dhe çdo sakrificë që bëhet në këtë Institucion duhet të përceptohet si ekspozim solemn i vlerave tona të pashtrrshme kombëtare. Së këndejmi, do ta konsideroja si detyrim kombëtar mbështetjen dhe përkrahjen e këtij Institucioni në të gjitha angazhimet e saj në drejtim të vjeljes së të mirave tona materiale e shpirtërore. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, pa dyshim që e mbanë të freskët përjetë

identitetin tonë duke e shpalosur shkencërisht atë para çdo gjenerate e brezi të tashmë dhe të atyre që vijnë. Ja pra pse duhet të kemi qasje kombëtare kur është në pyetje ky Institucion, sepse atë e kemi dritare nga e cila hidhet shikimi mbi vlerat materiale dhe shpirtërore mbarëkombëtare.

H. Sulejman ef. Rexhepi
Reisul Ulema i BFI-së

*-Të nderuar dhe të dashur vëllezër dhe motra,
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore në Shkup, që nga themelimi para dhjetë viteve, është pishtari dhe flakadani ynë në këto hapësira, për njohjen, përkrahjen, ruajtjen dhe bartjen e trashëgimisë tonë ilire, arbërore dhe shqiptare gjatë shekujve deri në ditët tona. Stuhitë dhe errësirat e ndryshme mundohen t'na shlyejnë nga fytyra e tokave tona martire. Avokati ynë është historia dhe arkeologjia, lashtësia dhe autoktonia, vëllazëria gjithëshqiptare, vetëdija dhe përcaktimi ynë që mbështet në këtë parim: "Pa histori nuk ka të tashme dhe ardhmëri".
Uroj vazhdim të hovshëm, shëndet dhe vullnet, punë të mbarë dhe të bekuar në këtë mision të shenjtë dhe të domosdoshëm.*

Don Lush Gjergji
Vikar gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës - Prishtinë

*-Kam kënaqësinë që të përuroj Institutin shqiptar të Shkupit për punën e suksesshme dhjetëvjeçare.
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore, ishte dhe mbetet një vlerë e madhe e shqiptarëve të Shkupit dhe të mbarë Maqedonisë në përgjithësi.
Si kryetar i Komunës së Çairit, kisha rastin që të jem pjesë e shumë aktiviteteve me rëndësi të madhe kombëtare që bëri ky Institut gjatë këtyre viteve.
Shpresoj që punëtorët shkencor të këtij institucioni, me elan dhe energji edhe më të madhe do të vazhdojnë punën dhe misionin e tyre, drejt zbardhjes së të vërtetave historike dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë të pasur kulturore e shpirtërore.*

Izet Mexhiti
Kryetar i Komunës Çair të Shkupit (2005-2017)

-Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve me seli në Shkup, pa dyshim se është një nga institucionet më serioze shkencore dhe kulturore shqiptare në gjithë rajonin. Me punën e palodhshme të ekipit të shkëlqyer, Instituti sidomos këto vitet e fundit, ka bërë punë të mëdha në ruajtjen e identitetit shqiptar të Shkupit.

Me frymën kombëtare të Institutit shqiptar të Shkupit, është zbardhur skencërisht në më shumë fusha edhe veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës. Me këtë frymë kombëtare, Hasan Prishtina iu rikthye Shkupit me bustin madhështor në Sheshin Skënderbeu.

Urime këtë përvojë jubilar, dhe faleminderit për gjithçka që bëni për trashëgiminë e frymës hasaniste në Shkupin tonë.

Cand. dr. Mehmet Prishtina
Pinjoll i familjes atdhetare të Hasan Prishtinës

-Kur më kërkuan të shkruaj diçka për Institutin me emër të gjatë por interesant kuptova se çfarë zhvillimi të mrekullueshëm kanë përjetuar brenda një kohe të shkurtër ky Institut dhe njerëzit e ndërlidhur me të. Më kujtohet – duhet të ketë qenë fundi i 2007-ës – kur kolegu im Albert Hani më kërkoi të vi e ta vizitoj Institutin. Isha kureshtarë ta njoh atë. Atë kohë Instituti kishte zyrat në Kurshumli Han-in e bukur. Mendova se ishte vendi i duhur për një institucion të tillë. Por nga shkencëtarët dëgjova se ato nuk kishin asgjë tjetër përveç zyrave. Nuk kishin mjete për kërkime, libra, udhëtime, pra vetëm kompjuterë. Duke njohur Institutin dhe njerëzit që punojnë aty, disi mu rrit dëshira për të bashkëpunuar me ta. Më kujtohet se Skënder Asani më dha një broshurë të vogël. Ka një polemikë, tha ai, dhe ka të bëjë me Skënderbeun. Në fakt broshura u bë lidhja, diçka si çështja kyçe që na lidhi bashkë. Një i ashtuquajtur shkencëtar citohet të ketë thënë se Skënderbeu nuk mundet të jetë shqiptarë pasi ato njerëz nuk janë të aftë të sjellin dikë aq të shquar sa ai dhe si pasojë ai solli disa prova që Skënderbeu ka prejardhje maqedonase. Pra kjo është ajo që ne kemi të përbashkët: të luftojmë kundër abuzimit të historisë nga politikanë që përpiqen të nxisin tensione dhe të çojnë deri në përdorimin e dhunës për të arritur qëllime politike. Për mua Instituti shërben për: besim në humltime serioze shkencore, përmbledhje e bashkëpunimit mes grupeve etnike në kursin e historisë, zotim për të rezistuar ndaj presioneve të partive politike dhe politikanëve si dhe vendosmëri për të zhvilluar bashkëpunimin me sa më shumë insti-

tucione. Si rrjedhojë instituti ka marrë pjesë në debate publike lidhur me rolin e historisë. Gjatë periudhës që po zhvilloheshin demonstratat e dhunshme në Shkup u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi me Institutin e Historisë Kombëtare të Maqedonisë. Në fillim bashkëpunimi nuk ishte i lehtë por vendosmëria e Institutit dhe veçanërisht Skender Asanit por tu mos u dorëzuar para emocioneve dhe qëndrimi për kërkime të përbashkëta pati sukses në fund dhe bashkëpunimi u thellua. Në fakt bashkëpunimi arriti një dimension të ri, ku të dy Institutet vendosën që të punojnë së bashku me Qendrën Memorialë të Holokaustit dhe Komunitetin Hebre. Tani në festën e përbashkët të përvjetorit të mundshme janë mënyra të reja. Dialogu ndëretnik dhe ndërjetar ka filluar. Institucionet e historisë dëshmuar rëndësinë e tejkallimit të tensioneve dhe shtrimin e rrugës së mënyrave të reja që kanë të bëjnë me historinë. Jam e lumtur që isha dëshmitare e këtij zhvillimi të jashtëzakonshëm dhe që isha në gjendje të jap sado pak mbështetje.

Silke Maier-Witt
Aktiviste për të drejtat e njeriut

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP

“10 vjet - ITSHKSH”

Redaktor gjuhësor:

Mr. Eroll Sejdiu

Redaktor teknik:

Naser Fera

Shtypi: Focus Print - Shkup

Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.7(=18:497.7)

DHJETË

10 vjet - ITSHKSH : (monografi) / [redaksia e botimit Sefer Tahiri, Sevdail Demiri, Besnik Emini]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2017. - 96 стр. : фотографии ; 21 см

ISBN 978-608-4653-66-0

1. Гл. ств. насл.

а) Албанци во Македонија - Културологија

COBISS.MK-ID 105430026